



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 DHJETOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26. DECEMBRA 2013. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
7. Propozimi i GP të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin për Integritet Evropian.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova za 2014. godinu,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o tretiranju izgradnji bez dozvole,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o posebnim tarifama akcize za početnu proizvodnju i malu proizvodnju alkoholnih produkata proizvedenih na Kosovu,
6. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi sa Odlukom Predsednice o vraćanju Zakona o robi oslobođenoj od carinskog poreza i robi sa nula carinskim porezom,
7. Predlog PG LDK za zamenjivanju članova u Komisiji za evropske integracije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Ditët e fundit ka ankesa të shumta nga qytetarët e Republikës së Kosovës që i drejtojnë në adresë të KEDS-it, duke filluar që nga shpërndarja e rrjetit elektrik, fryrja e faturave, ndërprerja e shpeshtë e energjisë elektrike dhe deri më të rëndat - shkaktimi i djegieve të shtëpive dhe ndërprerja e furnizimit me energji elektrike të Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe objektit të Komunës në Skenderaj. Kjo u pamundëson qytetarëve të marrin shërbimet e nevojshme dhe të domosdoshme për ta.

Kjo gjendje e krijuar është e papranueshme dhe e pajustificueshme. Prandaj, i bëj thirrje KEDS-it që menjëherë ta stabilizojë gjendjen me furnizim dhe shpërndarje të energjisë elektrike në gjithë Kosovën, e me theks të veçantë kërkoj urgjentisht që ta stabilizojë gjendjen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Skenderaj dhe në objektin e Komunës së Skenderajt, sepse këto dy institucione lidhen direkt me shërbimet e qytetarëve.

Prandaj, nuk është etike të luhet me dinjitetin e qytetarëve të asaj treve, kur dihet se tashmë të gjitha faturat e energjisë elektrike janë paguar me rregull.

Qytetarët janë treguar gjithmonë tepër tolerantë dhe kanë treguar mirëkuptim në vazhdimësi.

Por, të nderuar, çka është tepër është tepër dhe qytetarët e Republikës së Kosovës janë lodhur me këtë padrejtësi që u bëhet në vazhdimësi nga KEDS-i në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën në emër të Grupit.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Unë dola ta marr fjalën sot dhe t'i drejtohem këtij Kuvendi të nderuar për një personalitet të veçantë të historisë moderne të Kosovës, i cili arriti që një koncept politik ta shndërrojë në kauzë politike të brendshme dhe në kauzë politike ndërkombëtare.

Një personalitet politik, i cili arriti që të gjitha zgjedhjet ku mori pjesë t'i fitojë me votë plebishitare të qytetarëve të Kosovës, për një personalitet politik, i cili i trajtoi me dinjitet edhe kundërshtarët e vet dhe për një personalitet politik, i cili arriti t'i japë dinjitet vendit të vet që është Kosova.

Po flas për kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe për kryetarin e Republikës së Kosovës, që tashmë nuk është në mes nesh, presidentin historik të Kosovës, doktor Ibrahim Rugova.

Ky personalitet tashmë është jashtë suazave të personalitetit të një partie politike, prandaj mendoj se është një personalitet i cili na takon të gjithëve.

Arsyeja pse e mora fjalën sot është se rivalët e tij të dikurshëm politikë dhe rivalë të dikurshëm profesionalë kanë arritur që sot ta diskutojnë në mënyrën me të ulët të mundshëm një personalitet të tillë dhe nuk është e moralshme dhe e ndershme që trajtohet në mënyrë të tillë një personalitet historik, i cili rivalët e vet politikë i trajtoi me dinjitet dhe i mundi me plebishit popullor. Nuk mund të gjykohet nga kundërshtarët e vet politikë dhe nuk mund të gjykohet nga kundërshtarët e vet edhe profesionalë.

Personaliteti dhe vlera e presidentit Rugova është një personalitet, i cili nuk mund të kontestohet nga kundërshtarët e vet në aspektin moral dhe në aspektin politik dhe profesional.

Sot ne mund të themi se ky personalitet duhet të gjykohet dhe vlerësohet nga historia, sepse historia kërkon distancën dhe kërkon vlerësimin.

Vlerësimin dhe gjykimin historik po e përsëris se nuk mund ta bëjë as kundërshtari politik dhe as rivali politik dhe as kundërshtari dhe rivali apo miqtë e dikurshëm profesionalë.

Mendoj se jemi në një situatë kur personaliteti dhe vlera e Ibrahim Rugovës tashmë është jashtë sferës të trajtimit politik të një partie politike.

Dhe, unë dola ta marr fjalën për sot vetëm që të kërkoj që të trajtohen me dinjitet të gjitha vlerat historike, kombëtare dhe tradicionale të shqiptarëve. Dhe, ndër to më e spikatura është vlera e presidentit Rugova, e cila vlerë si koncept politik, si kauzë politike u përkrah në mënyrë plebishitare nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe si koncept politik dhe kauzë politike u përkrah edhe me ndërhyrjen ndërkombëtare si kauzë e përbashkët edhe ndërkombëtare e botës demokratike dhe të civilizuar. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti e ka fjalën, në emër të Grupit.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Politikanë të ndryshëm shqiptarë, jo vetëm kryeministri aktual, janë ngritur në karrierë dhe kanë ardhur në qeverisje në këto 25 vjetët e fundit me tri vendime kryesore, njëri në rrafshin ekonomik e dy të tjerë në rrafshin politik.

Në rrafshin ekonomik duke e pranuar dhe zbatuar privatizimin neoliberal, ndërkaq në rrafshin politik së pari duke hequr dorë nga shqiptarët jashtë Kosovës dhe trojet e tyre autoktone, pra nga shqiptarët në Mal të Zi, Preshevë, Medvegjë e Bujanoc dhe ata në Maqedoninë Perëndimore.

Dhe, hapi apo vendimi i dytë politik duke kontribuar në çarmatosjen dhe demilitarizimin e shqiptarëve, pra në shuarjen e UÇK-së, të UÇK-në Maqedoni dhe të UÇPMB-së.

Fundi i luftërave në Kosovë, në Kosovë Lindore dhe në Maqedoni përputhet me çarmatosjen e ushtrive shqiptare dhe jo të atyre serbe e maqedonase.

Ky moment dhe ky fakt i ka përkufizuar dhe i ka përcaktuar zhvillimet e mëtutjeshme politike shumë më tepër sa që mendohet.

Paqja e fituar nëpërmjet demilitarizimit të shqiptarëve, posteriori i ka riinterpretuar shqiptarët dhe kryengritjet e tyre të armatosura si problem themelor e jo shtypjen e shfrytëzimin ndaj shqiptarëve që i shkaktoi ato kryengritje.

Pra, ngritja individuale me karrierë e politikanëve për një qeverisje e pushtet realizohej nëpërmjet rrudhjes së qëllimit dhe të drejtave kolektive të shqiptarëve.

Më 14 janar të vitin 2006, kuvendet komunale të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit e miratuan platformën për të drejtat, vullnetin dhe interesat e shqiptarëve.

Shtatë vjet më vonë, më 12 janar të vitit 2013, u rikonfirmua kjo platformë nga këto kuvende komunale.

Ashtu siç u braktis në Vjenë, ajo u shpërfill edhe në Bruksel, duke mos qenë parakusht për dialog me Serbinë, nuk u bë as temë në dialog me të.

Sot në Kosovë të gjithë jemi dëshmitarë që po thellohet decentralizimi mbi baza etnike, ndërsa në Serbi ka centralizim mbi baza etnike.

Gjykatat dhe prokuroritë komunale dhe Gjykata për Kundërvajtje u shuan në Preshevë e Bujanoc, në vitin 2010, kompetencat u bartën në Gjykatën Themelore në Vranjë dhe atje tash janë 53 gjykatës serbë dhe vetëm tre sish shqiptarë.

Nga 446 të punësuar në institucione shtetërore në Preshevë 212 janë shqiptarë e 225 serbë, nga 764 të punësuar në Bujanoc, 160 janë shqiptarë dhe 597 janë serbë, nga 386 të punësuar në Medvegjë, shqiptarë janë vetëm 15, kurse serbë 366. Gjithsej në Preshevë,

Medvegjë e Bujanoc në institucione shtetërore janë të punësuar 1 596 veta, prej tyre 387 shqiptarë apo 24,25%, dhe 1 188 serbë, apo 74,44%.

Shqiptarët përbëjnë 89,1% të popullsisë në Preshevë, 54,69% të popullsisë në Bujanoc dhe 26,17% të popullsisë në Medvegjë, apo marrë së bashku në këto tri komuna shqiptarët janë 64,74% të popullsisë.

Pra, shqiptarët përbëjnë gati dy të tretat e popullsisë, por nuk marrin pjesë as me çerekun e të punësuarve në institucionet shtetërore në ato tri komuna.

Se si shqiptarët janë të diskriminuar në veri të Kosovës e dimë të gjithë, por këtu do të përmend qysh ata janë të diskriminuar edhe për shembull në Shtërpçë.

Në Shtërpçë janë bërë 25 milionë investime edhe janë tre milionë euro borxhe, pra gjithsej 28 milionë euro për tre vjet e gjysmë. Nga këto vetëm 3% janë për vendbanimet e banuara me shqiptarë, e dihet që shqiptarët përbëjnë 35% të popullsisë së Shtërpçës.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Asnjëherë, asnjë cent, për asnjë çështje, Qeveria aktuale e Kosovës nuk e dha për shqiptarët matanë kufirit, ndërkohë që ata kontribuan njësoj në çlirimin e Kosovës dhe e paguan çmimin më të lartë meqenëse mbetën jashtë Kosovës së pavarur.

Pa Prishtinën dhe Tiranën zyrtare, shqiptarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc do ta kenë të vështirë edhe të mbijetojnë, e lëre më të zhvillohen.

Po e theksoj edhe një herë, me tri vendime janë ngjitur në karrierë shqiptarët në çerekshkullin e fundit, duke e pranuar e zbatuar privatizimin neoliberal, duke hequr dorë nga bashkimi kombëtar dhe duke i çarmatosur e demilitarizuar shqiptarët.

Por, të gjitha këto karriera dhe secila prej tyre janë karriera të tradhtisë, të turpfit, janë karriera të padrejtësisë, janë karriera që e dëmtojnë brezin aktual dhe karriera, të cilat i rrezikojnë brezat e ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse kanë kaluar muaj të tërë që nga vendimi jo i drejtë i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi ndërmarrjet e Deçanit “Apiko” dhe “Iliria”, Qeveria dhe Presidenca e vendit nuk morën as më të voglin hap në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Tamam sikur te ky rast të bëhej fjalë për një vend apo një planet tjetër, e jo për zonën absolutisht më të bukur turistike në vend.

Kur ti nuk merresh me punën tënde, atëherë s'do mend se të tjerët merren me ty, e kur dikush merret me ty dhe problemet e tua, vaj halli për ty, thotë populli.

Ditëve të fundit jemi dëshmitarë të ngritjes së këtij problemi nga ambasadori gjerman nëpërmjet një memorandumit shtatëpikësh, i cili, në thelb, ndonëse shprehet për zgjidhjen e problemit, realisht veçse e keqëson atë, sepse zgjidhja e drejtë është shumë e thjeshtë.

Kthimi i pakusht i pronave të pronarëve të tyre denbabaden, e jo vazhdimi i diskriminimit të kësaj komune me ose pa dashje nga faktori ndërkombëtar e vendor, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër sjellja e qëllimshme dhe jashtë çdo norme njerëzore e përfaqësuesve të Manastirit të Deçanit lidhur me këto prona, të cilat drejtpërdrejt po e pengojnë edhe ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë dhe po e ngulfatin pa asnjë mëshirë zhvillimin ekonomik dhe të ardhmen e qytetarëve të komunës së Deçanit.

Ua rikujtojmë edhe një herë të gjithë zyrtarëve vendorë e ndërkombëtarë se ishin pikërisht prijësit e Manastirit të Deçanit ata të cilët gjatë luftës së fundit në Kosovë i bekuan me ujë dhe tym qindra paramilitarë serbë, të cilët i porositën që të vrasin dhe të masakrojnë me qindra qytetarë, jo vetëm të Deçanit, por edhe më gjerë.

Mu nga kjo foltore edhe një herë i bëj thirrje këtij Kuvendi që menjëherë t'i marrë masat e nevojshme në drejtëm të zgjidhjes së kësaj çështjeje, që Kuvendi i Kosovës ta nxjerrë një ligj të veçantë me anën e të cilit do t'i hedhë poshtë të gjitha vendimet e masave të dhunshme nga marsi i vitit '89 e deri në qershor të vitit '99, sepse vetëm në këtë mënyrë do të evitohet një situatë jo e këndshme për të gjithë ne.

E them këtë, sepse tashmë në komunën e Deçanit kanë filluar reagimet e të gjitha subjekteve politike, Kuvendit të Komunës, shoqatave të shumta, përfshirë edhe atë historianë të Kosovës "Ali Hadri", dega në Deçan, dhe shoqëria civile atje.

Edhe një herë dua t'ua rikujtoj faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë që të mos provokohet situata, që çdo vendim që është në kundërshtim me interesat e qytetarëve të kësaj komune do të jetë i papranueshëm dhe si i tillë do të sjellë pasoja të paparashikueshme në komunën e Deçanit.

Andaj, nga kjo foltore kërkoj që Kuvendi i Kosovës, Presidenca e vendit dhe Qeveria e Kosovës ta kryejnë punën dhe obligimin e tyre, t'i ndërpresin këto lojëra që po e mbajnë pezull të sotmen dhe të ardhmen e komunës së Deçanit. Kërkoj që pa asnjë kusht pronat e këtyre dy ndërmarrjeve t'i kthehen në menaxhim Komunës së Deçanit dhe të njëjtat riaktivizohen, sepse me riaktivizimin e tyre do të përfitojnë jo vetëm qytetarët e komunës së Deçanit, do të përfitojë Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče,

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani, ministri,

Poštovani kolege poslanici,

Na osnovu člana 5. tačka 1. Ustava Kosova koje jasno kaže da su službeni jezici na Kosovu albanski i srpski sa ciljem stvaranja okruženja sa sve zajednice, da one mogu da se izraze i štite svoj identitet i bazirajući se na Međunarodnu konvenciju o zaštiti građanskih i političkih prava, Evropsku konvenciju o zaštiti ljudskih prava, donet je Zakon o upotrebi službenih jezika i pisma, gde se kaže da su albanski i srpski jezik zvanični službeni jezici na Kosovu i njihovih alfabeti.

Gospodo poslanici,

Svrha ovog zakona je da obezbedi ravnopravni status albanskog i srpskog jezika kao službenih jezika na Kosovu, kao i jednaka prava za njihovu upotrebu u svim institucijama na Kosovu, kako bi zajednice mogli da očuvaju, održe i promovišu svoj jezički identitet.

Moramo biti iskreni i reći da Zakon koji je na snazi ne krši i ne zadire u pravo i interes zajednica na Kosovu, ali isto tako moramo priznati da postoje drastično kršenje tog istog Zakona počevši od korišćenja centralnih nivoa institucija, opštinskim institucija javnom kao i privatnom sektoru.

Ovo sve govorim zato što je kršenje Zakona došlo do to mere da povređuje osnovno ljudsko dostojanstvo, i ako se nešto ne uradi ostaće samo jedan zvanični jezik na Kosovu, i mi moramo znati da li je to cilj u ovom momentu i ovom trenutku kosovskom društvu.

Postoje mnogi negativni primeri koji potvrđuju moju konsultaciju od kojih naveću samo neke određene primere, koji su vidljivi i koje svakodnevno utiču na život i rad građana Kosova.

O topografskih znakova, deklaracija, na uvoznim proizvodima, koji su isključivo na albanskom jeziku, bilo da su to prehrambeni, ili i farmaceutske proizvode, pa tako građani Kosova koji ne znaju albanski jezik kupuju proizvode a ne znaju šta kupuju, i tako dovode u pitanje svoje zdravlje, kao i zdravlje svojih porodica.

Gospodo poslanici,

Moram da kažem da određeni asistenti u nekim institucijama preuzimaju tretiranje zakona na način koji njima odgovara. A kada jednom poslaniku, šefu parlamentarne grupe i zameniku predsednika parlamentarne komisije mogu na taj način da šalju dokumenta ili materijal koji je od velike važnosti za sam naš rad, moram da se zapitam kuda sve ovo vodi, i do koje mere se krši zakon i na koji način se tretira srpski jezik kao drugi zvanični jezik na Kosovu.

Zbog korektnosti i zbog svih koji poštuju Zakon i Ustav, moram da izdvojim slučaj i da zamolim ovom prilikom ministra Bezbednosnih snaga Kosova da reaguju da reši da se zakon i Ustav Kosova poštuju i da pojedinci u tako visokim strukturama Kosova ne krše zakon i ne rušavaju ugled institucijama Kosova. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu- Kodra.

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fjala ime sot lidhet me dy draft-rregulloret e fundit të Komisionit të Pavarur të Medieve dhe kur jemi te kjo unë patjetër dua që të shpreh falënderim karshi një vendimi të fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili e ktheu ligjshmërinë, do të thotë shkarkimin e anëtarëve të Bordit të KPM-së.

Unë besoj shumë që në këtë institucion do ta kemi fatin e përzgjedhjes së njerëzve të mirë dhe të dëshmuar, të cilët vërtet do ta luajnë rolin e rregullatorit të medieve, duke qenë në shërbim të një tregu të lirë medial.

Dhe, shqetësimi im lidhet konkretisht si pjesë e Komisionit për Integritet Evropian, në këtë seancë, do të thotë unë shpreh shqetësimet me veprimet e fundit të KPM-së karshi medieve të pavarura elektronike në Kosovë, konkretisht se janë këto dy draft-rregulloret e fundit të KPM-së, njëra për rritjen e taksës së licencës dhe tjetra draft-rregullore, që është për shpërndarje të shërbimeve mediale në vend.

Komisioni i Pavarur i Medieve si institucion i themeluar nga ky Kuvend, nëpërmjet këtyre draft-rregulloreve po rrezikon funksionimin e mbi 120 subjekteve mediale, duke vënë kështu në rrezik lirinë e shprehjes që pa dyshim mbetet njëra ndër kriteret kyçe të standardeve evropiane.

Të nderuar deputetë,

Në këto dy draft-rregullore të KPM-së nuk janë marrë për bazë vërejtjet dhe po ashtu grupet e interesit nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e draftimit të këtyre rregulloreve.

Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për Kosovën kërkohet që KPM-ja ta ruajë pavarësinë, integritetin dhe të jetë mekanizëm në shërbim të qytetarëve të saj. Në këtë mënyrë, rregulluesi i tregut medial në Kosovë duhet t'i kthejë mbrapa për diskutim këto draft-rregullore dhe të merren parasysh parametrat realë financiarë brenda të cilëve funksionojnë mediet në Kosovë.

Vetëm kështu, KPM-ja do ta ruajë pavarësinë e vet, duke mos rënë në ndikimin e presioneve politike dhe duke promovuar lirinë e shprehjes të gjitha palët e interesit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Po e mbyllim edhe këtë vit dhe si duket kjo do të jetë seanca e fundit, pa e miratuar Projektligjin për plotësim-ndryshim për statusin për të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve e tjerë, por që është sjellë këtu për çështjen e grave të dhunuara.

Projektligji do të duhej të ishte miratuar që në maj, në rast se do të ishte zbatuar Rregullorja e Kuvendit.

Se sa është i rëndësishëm ky projektligj për gratë e dhunuara gjatë luftës, unë sot do t'ua përcjell nëpërmjet zërit të njëres prej këtyre grave, e cila më është lutur që ta sjell këtu lutjen e saj dhe të shumë grave të tjera.

“Mirëdita!

Unë jam një viktimë e dhunës prej serbëve, jam nënë e katër fëmijëve, jetoj me kushte shumë të rënda. Pas dhunimit, burri më ka lënë, tash jetoj me katër fëmijë, pa kurrfarë të ardhurash. Apeloj te të gjithë deputetët që ta ngrenë zërin dhe të na mbështetin ne dhe ta votojnë këtë ligj.

Ju lutem, ju lutem shumë, sepse unë jam viktimë e dhunës, e rrahjeve, e maltretimeve tri ditë pa u ndalur rresht. Dhëmbët m'i kanë nxjerr me dara, ma kanë djegur me cigare fytyrën, duart. Ju bëj apel vëllezër dhe motra deputete që ta mbështetin këtë projektligj. Ju lutem!”.

Faleminderit! Shpresoj që ky Kuvend të mos jetë më indiferent në lidhje me këtë çështje kaq të rëndësishme.

Zëra si të kësaj gruaje mund t'i dëgjoni në çdo cep të Kosovës. Shpresoj që vitin tjetër ta fillojmë me miratimin, të jetë vendimi i parë i këtij Kuvendi, të këtij projektligji, që do ta siguronte së paku mbijetesën e këtyre grave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Por, është mirë të bësh diferencë ndërmjet detyrës së gazetarit dhe të deputetes.

Ju lutem, të mos të keqpërdoret foltorja. Në foltores drejtohen deputetët. Ju mund të lexoni atë që është thënë, mund t'ua dorëzoni materialin deputetëve, po foltorja është e deputetëve.

Edhe një herë po e përsëris, mos e ngatërmoni detyrën e gazetarit me detyrën e një deputeti!

Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

19 nëntori i këtij viti nuk ishte ditë e rëndomtë për Kosovën. Atë ditë hyri në Kosovë kundër vullnetit të qytetarëve kryeministri i Serbisë dhe bashkëpunëtori e pasardhësi i politikës së Milosheviqit, Ivica Daçiç.

Po atë ditë, në mesin e shumë qytetarëve që u ndien të indinjuar ishte qytetari Riza Nura, i cili vetëm pse shprehu reagimin e drejtë e qytetar ndaj shkeljes së sovranitetit dhe integritetit të vendit nga një kriminel, bashkëpunëtor i djeshëm e i afërt i Milosheviqit.

Riza Nura u rrah, u përdhunua dhe sot stigmatizohet nëpërmjet procedurave penale nga aparati i shtetit, i cili në vend që t'i mbrojë qytetarët e tij dhe të mos e lejojë kryekriminelin e Serbisë të shkelë mbi tokën tonë, ai i mbron po ata kriminelë edhe ndaj ofshamave e thirrjeve për dinjitet qytetar e drejtësi në këtë vend.

Riza Nura atë ditë u arrestua, u dërgua në stacionin policor, u rrah, u maltretua psikikisht e fizikisht, që nga vendi i arrestimit e deri në stacionin e policisë, kurse tani po ndiqet për kinse kryerjen e veprave penale.

Në vend që drejtësia të merret me ata që e lejuan kriminelin Daçiq të futet në Kosovë dhe me ata që e keqtrajtuuan qytetarin Nura, ajo po e ndjek Riza Nurën, i cili po hetohet për veprën e deliktit verbal.

Dëshiroj t'ia dërgoj përkrahjen dhe mbështetjen time të nderuarit Riza Nura për veprimin e drejtë e qytetar, sikundër që nga këtu dua të shpreh indinjatën time nga kjo klasë politike dhe ky sistem i drejtësisë i politizuar dhe i korruptuar, të cilët së bashku dhunojnë qytetarët e tyre, vetëm e vetëm për të mos i prishur raportet e veta me kriminelët e Serbisë.

Sot, edhe pas 14 vjetëve të pasluftës, e cila shënoi krimet më të papara dhe gjenocidin serb mbi popullin shqiptar, kur qytetarëve po u kthehen në kujtesën e tyre krimet më barbare të Serbisë së fundmi në varrezën masive në Rashkë, ku janë gjetur së paku 250 shqiptarë të vrarë nga ushtria dhe policia e Daçiqit dhe Milosheviqit, qytetarët në Kosovë rrihen e maltretoheshin me mbrojtje të Ivica Daçiqit dhe krimeve të tij.

Ne u themi zotit Nura dhe qytetarëve të vendit që drejtësia vërtet do të vihet në vend herë do kur për këtë rast dhe për shumë raste të tjera, kur ky sistem i kalbur kriminel të vihet para drejtësisë qytetare. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Po e shfrytëzoj rastin që me këtë pikë, si rast të përshtatshëm në këtë pikë për çështje që ngrihen jashtë rendit të ditës, t'i shtroj dy çështje.

Në fakt, njëra ka të bëjë me ide dhe iniciativë për punën vullnetare. Po e shfrytëzoj rastin edhe të pranisë të numrit të madh të anëtarëve të Qeverisë dhe të ministrit të Punës këtu.

Meqenëse te ne është e rregulluar në mënyrë tjetër me Ligjin e punës, mendoj që në shkallë çfarë kemi arritur dhe ne tash me një zhvillim më të mirë urban, me një zhvillim më të mirë në shoqëri dhe me një aktivizim të komuniteteve, krejt kjo nuk mund t'i përcjellë kufizimet që i kanë ose ministritë e Qeverisë, e sidomos ato buxhetore. Mendoj që është koha ta rregullojmë me një ligj dhe se janë për punën vullnetare, ka në botë shumë organizata që janë aktive në këtë drejtim prej Kombeve të Bashkuara, organizata të ndryshme ndërkombëtare që e mbështetin punën vullnetare, por ka edhe shtete të ndryshme, të cilat aktivitetin vullnetar e kanë si partner të rëndësishëm. Pra, me ligj duhet

të bëjmë stimulime të veçanta për këtë lloj aktiviteti. Mendoj që shoqëria jonë përfiton shumë në këtë drejtim.

Mendoj që Qeveria dhe shoqëria civile do të ishte mirë të bashkëpunojnë sa më shumë, në mënyrë që të ketë një iniciativë të tillë sa më shpejt. Nëse kjo nuk bëhet më shpejt, unë personalisht do të vij me iniciativë brenda Kuvendit dhe u kërkoj po ashtu edhe komisioneve përkatëse parlamentare që ta trajtojnë këtë çështje.

Edhe çështja e dytë, meqenëse u përmendën shumë KPM-ja dhe Rregullorja, mendoj që është një çështje tjetër e pambuluar në këtë drejtim, pra çështja e portaleve që nuk ka qenë për shkak të zhvillimeve teknologjisë tash është shumë më e përdorur. Është puna e komenteve, mendoj që duhet të mbulohen me ligj, ndoshta ka nevojë që qysh tash ligji edhe disa shtete të Evropës që nuk kanë pasur nuk janë përballur më herët me këto, tash kanë filluar t'i rregullojnë këto. Ju i keni parë që më shumë nganjëherë bëhen temë-komente se sa vetë informacionet që janë në portale.

Duke e shfrytëzuar rastin të respektojmë gjithçka që ka të bëjë me lirinë e medieve, gjithçka që ka kthyer me përmbushjen e kriterëve që dalin nga ajo edhe që janë thënë në Raportin e Progresit, mendoj që në këtë rrugë duhet shikuar të rregullohen sa më mirë këto, duke mos e cenuar aspak informimin e lirë, informatën sa më të shpejtë, por duke nxjerrë në pah identitetin e gjithë atyre që japin informatë ose komente, qoftë në mjetet elektronike, ose diku tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja e fundit për këtë pikë të rendit të ditës është deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që të shpreh shqetësimin lidhur me betimin e kryetarit të ri të Graçanicës, Branimir Stojanović, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Sipas medieve vendore, një gjë e tillë, pra betimit pa flamurin e Republikës së Kosovës, e konfirmoi ditë më parë Stojanović, i cilie bëri betimin solemn në sallën e Kuvendit Komunal, ku ishte i vendosur flamuri i Serbisë, i BE-së dhe i Kombeve të Bashkuara, por jo flamuri i shtetit të Kosovës. Ligji për simbolet shtetërore kërkon qartë që komunat duhet t'i përdorin simbolet shtetërore krahas atyre të komunës.

Në ceremoninë e betimit në Graçanicë, përpos ministrit për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Aleksandër Vulin, ishte i pranishëm edhe zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Slobodan Petroviq, të cilit si duket nuk i pengoi mungesa e flamurit të Kosovës, me gjithë faktin që ai do të duhej të ishte aty pikërisht për të siguruar respektimin e ligjeve dhe të Kushtetutës së Kosovës.

Nëse ministri Petroviq dhe zëvendëskryeministri nuk reagon ndaj këtyre veprimeve të kryetarëve të komunave me shumicë serbe, atëherë një gjë e tillë tregon një papërgjegjësi

në funksionin, të cilin e ushtron dhe duhet të ndërmerren dhe masa urgjente nga shefi i tij politik, përkatësisht nga kryeministri Hashim Thaçi.

Çfarëdo tolerimi ndaj veprimeve jolegale do të ishte amnisti e shkeljeve, andaj ministri Petroviq e ka për obligim ta mbrojë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Nuk duhet harruar se nga kryetarët e dhjetë komunave me shumicë serbe, nëntë prej të cilëve vijnë nga Lista “Srpska”, një numër i madh i tyre kanë deklaruar publikisht se nuk do t’i njohin ligjet e Kosovës. U takon institucioneve të Kosovës, e jo dikujt tjetër që të reagojnë ndaj veprimeve të tilla, e jo të heshtin, sepse heshtja në këtë rast, siç ishte edhe rasti i Graçanicës, paraqet asgjë tjetër, pos pranim të asaj gjendjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për personat e verbër është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në qershor të vitit 2012 dhe ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, sipas të cilit ligj, përveç të drejtave dhe beneficioneve të tjera që do t’i ketë kjo kategori e shoqërisë, do të duhej ta merrnin edhe pagën mujore për personat e verbër dhe përcjellësin e tyre. Pyetja ime zoti ministër është: Kur do të fillojnë të paguhen këto paga të garantuara me ligj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Kao što znate, Zakon za slepe je bio usvojen u julu 2012. godine, a njegova implementacija je trebalo da započne od 1. januara 2013. godine, i za njegovo sprovođenje mi smo bili obavezni Ministarstvo za rad da pripremi podzakonske akte i gde smo mi preduzeli sledeće mere:

Od usvajanja Uredbe za funkcionisanje o medicinskoj Komisiji prema članu 17. stava 2. Zakona Ministarstva za rad, izvođivanje, pripremanje prijemnih obrazaca za materijalnu dobit svih slepih lica koji je sastavni deo ove uredbe, finansijska sredstva o sprovođenju zakona br. 04/L-092 za slepa lica, predviđena su u srednjoročnom okviru troškova 2014-2017 u iznosu od 1,8 miliona evra, i gde za penzije je pripremljen, izradio odluke o priznavanju prava za materijalnu dobit svih slepih.

Mesečni iznos koji će dobiti jedna slepa osoba prve grupe nakon ove odluke medicinske socijalne Komisije je 100 evra mesečno zbog slepih, i ovaj iznos će takođe biti, dobiti i njegov pratioc i druga grupa će dobiti po 100 evra mesečno. Do sada je kod medicinske socijalne komisije su pregledani 687 lica, od kojih u projekat vode se 495 za 5 godine, i 139 u drugoj kategoriji za 3 godine, dok je 65 njih je odbijeno.

Završna uredba Ministarstva za rad br. 02/2013 za funkcionisanje komisije i procedure prijave za ostvarivanja prava za svoje poslove koja je takođe ukinula uredbu postojeću, koja je dosad postojala je za funkcionisanje medicinske komisije. Nakon obavljanih priprema i izgradnje podzakonskih aktova unutar Ministarstvu za rad je počeo sa radom komisija o ispitivanju svih slučajeva slepih lica. Do sada je ispitano 700 osoba, i oko 650 su dobili prava. Mogu da vam kažem da se sama primena zakona, odnosno ishod beneficija poeti od januara 2014. godine, jer je ono što sam malo pre rekao i najbitnije u nekom sažetku uskraćeno, komisija je bila vrlo bitna da bi identifikovala ko su dobitnici i pogotovo koji su dobitnici sa pravom...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Edhe gjysmë minute, le ta përfundojë fjalinë ministri.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala puno podpredsedniče!

Po završetku rada komisije mi ćemo imati tačan broj. To je ono što smo i ranije rekli. Mi ne možemo da znamo kako je jedan utrošak zakona, ukoliko nemamo broj lica koji su dobitnici, tako da mi sad kad znamo broj lica koji su dobitnici, možemo utvrditi utrošak zakona i možemo naravno da počnemo sa sprovođenjem, odnosno sa plaćenjem beneficija svima koji su po zakonu podležno, odnosno imaju pravo da dobiju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë zonja Mustafa? Po.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, ministër për përgjigjen!

Por, unë mendoj se fatmirësisht numri i këtyre personave nuk është aq i madh që Komisioni Mediko Social të mos ketë mundur ta kryejë këtë punë brenda një viti.

Por, pyetja ime tash është se a do t'i marrin në mënyrë retroaktive prej një janarit 2013 këto të ardhura personat e verbër?

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Mi ćemo naravno učiniti sve da retroaktivno plaćanje datom u sprovođenju zakona bude ispoštovano, i kao što sam malo pre rekao zakon jeste na snazi od prvog januara 2013. godine, to je ono što sam pre toga naznačio bili podzakonski akti, koji su morali biti napravljeni da bi mi imali tačni broj ljudi koji će biti dobitnici i samim tim imamo tačan broj ljudi koji će biti takođe ovaj korisnici.

Jedna stvar je tu bila onako prilično kompleksno, zato što svako od ovih slepi u toj drugoj kategoriji ima pravo na jednog-dva, čak i tri pratioca i utvrđivanje tih pratioca je malo tehnički zahtevan posao a pored toga ja vas posećam da svaki zakon kaže da nemate pravo da dobite beneficije dva puta od istog budžeta. Mi ovim ljude koje ćemo dobiti dobitnici za prava zakon o slepima takođe je vićina njih već postoji određen kategorijama privremenih penzija koji sad dobijaju od 60 euro. Prema tome, mi moramo njih tehnički da sa jedne liste skinemo da ih ubacimo na ovu drugu zbog toga malo je tehničko sprovođenje trebalo vremena, ali kao što sam rekao do kraja januara sledeće godine mi ćemo najkonkretnije i najdinamičnije početi sa implementacijom zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Zoti Marinković, e keni fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani ministre,

Prošlo je tri godine kako je kompania tada KEK potpisala sporazum sa opštinom Gračanica oko izgradnji dalekovoda, koji je trebalo da snabdeva struku u naselje u opštini struku u naselju opštine Gračanica, koja ima probleme redovnom snabdevanja električnom energijom.

O dogovorenog urađeno samo to da su postavljeni stubove mreže koje opština platila. Gospodine ministre, moram napomenuti da je vaš kolega prethodni ministar u Vladu, poslanicima ovog visokog doma rekao da će problem biti rešen do kraja godine, to jest do 31. 12. 2011. godine, sad smo na kraju 2013, ali obaveza je kada je KEK a sada KEDS imao i od toga nije uradio ništa, kada će radovi na dalekovodu koji su započeti više od 3 godine biti završeni, i na taj način kompanija KEDS izvršiti deo svoji deo baveza koji ima prema opštini Gračanica i prema građanima u toj opštini kako na najbolji mogući način zaštitili prava svojih potrošača?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër, ministra,

I nderuar deputet Marinković

Çështja e cila ka filluar të realizohet në nëntor të vitit 2011, është fjala për një largpërçues 10kV, e cila bazohet me marrëveshjen ndërmjet Komunës së Graçanicës dhe në atë kohë KEK-ut, tani vazhdon të jetë problem i KEDS-it.

Fjala është për një gjatësi prej 4-5 km largpërçues, prej të cilave 3 km janë të përfunduara. Dhe, marrëveshja decidive përcakton që obligimet e dy palëve, obligim i Komunës së Graçanicës ka qenë që të merret me lejet dhe sigurimin e pronave për kalim të linjës, kështu që të gjitha resurset, në bazë të informatave që tashmë i kemi edhe prej KEDS-it janë aty dhe posa kjo të kryhet problemi me pronat punët mund të vazhdojnë në afat shumë të shkurtër të kryhen.

Prandaj, ju ftoj edhe ju si deputetë që të bëni eventualisht ndikimin te organet e Komunës së Graçanicës që kjo punë ose këto konteste pronësore të kryhen për të vazhduar projekti.

Nuk është në interes as të kompanisë që materialet janë aty, të gjitha resurset janë aty, që kjo të ngecë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zoti Marinković?

GORAN MARINKOVIĆ: Ja bih samo jednu konstataciju, ministru. Svi imovinski pravni odnosi sa građanima, gde prolazi dalekovod i gde ostatak dalekovoda treba da prođe su rešeni, ja vas molim da vi u rukovodstvu izvršite vaš uticaj prema rukovodstvu KEDS-a, kako bi oni izvršili svoje obaveze, jer imovinske pravo su završeni, to je rešeno.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Atëherë, sigurisht që do të merrem me këtë dhe në rastin e parë do ta keni përgjigjen dhe nëse kjo qëndron që më the - përgjigjen e kam marrë prej KEDS-it, normalisht nuk i kam të gjitha informatat në tavolinë, do të keni përgjigje të saktë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Raportin e Progresit për vitin 2012, ndër të gjeturat është edhe mungesa e një marrëveshjeje formale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për t'i sqaruar dyshimet lidhur me mbetjet e personave të paidentifikuar në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë.

E thashë edhe javën e kaluar, mirëpo ministri nuk ishte i pranishëm, bëhet fjalë për trupat e shqiptarëve të vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë, trupa të vrarë të cilët janë hedhur në bregun e lumit Lepenc, e që pas reshjeve të shumta që ka pasur në pranverën e atij viti këta trupa janë bartur përmes lumit Lepenc në Maqedoni.

Dyshohet që qytetarët atje i kanë nxjerrë nga lumi këta trupa dhe i kanë varrosur në varrezat në Butel afër Shkupit. Në Raportin e Progresit për vitin 2011, mirëpo edhe për vitin 2012, si pengesë për identifikimin e këtyre trupave është marrëveshja formale ndërmjet dy republikave.

Pse, ministër, nuk është arritur një marrëveshje e tillë deri më tash?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja deputete, siç e përmendët edhe ju, ky rast ose kjo çështje është e njohur si çështja apo "Rasti i Butelit" dhe për këtë çështje në këto katër-pesë vjetët e fundit ka pasur dy

mendime: mendimi i parë ka qenë që viktimat e mundshme mund të jenë viktimat të luftës së Kosovës në vitin 1999 dhe janë bartur në territorin e Maqedonisë dhe janë varrosur atje dhe një mendim tjetër i dytë ka qenë që këta do të mund të kenë qenë qytetarë të Kosovës, të cilët si refugjatë kanë qëndruar në Maqedoni dhe gjatë kohës së qëndrimit të tyre atje kanë vdekur dhe janë varrosur në varrezat e lagjes Buteli, që është lagje e Shkupit.

Më lejoni t'ju informoj që në këto vitet e fundit në mënyrë sistematike është ngrehur një çështje e tillë. Së pari e ka ngritur zëvendëskryeministri Ramë Manaj, me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, në vitin 2009, si dhe nga ministrja Kelmendi një çështje e tillë. E ka ngritur ministri Haki Demolli dhe së fundi është marr në mënyrë intensive edhe vetë ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi.

Më lejoni t'ju them që në janar të 2011, pasi kjo çështje është ngrehur në Komisionin për Politikë të Jashtme dhe nga deputetët, edhe ne si Ministri e Punëve të Jashtme edhe një herë e kemi riinicuar këtë çështje nëpërmjet një note verbale që kemi dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Unë kam biseduar disa herë me ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë, po nëse ju jap një përmbledhje të shkurtër, qëndrimi i palës maqedonase është që kjo çështje nuk ekziston, që nuk ka dëshmi dhe fakte konkrete për një pretendim të tillë dhe informatat po ashtu të institucioneve të Kosovës flasin më shumë për një pretendim medial, më shumë çështje mediale, mediatike se sa diçka konkrete.

Unë çfarë mund t'ju them sot këtu është që do ta riinicijoj edhe një herë një çështje të tillë, por këtë çështje nga viti 2011 e kam ndjekur deri më tash, nuk ka ndonjë dëshmi konkrete, nuk ka ndonjë fakt konkret. Mendoj që politika e jashtme fillon këtu në Kuvendin e Kosovës. Pas kësaj pyetjeje parlamentare unë do ta ngre edhe një herë me palën maqedonase dhe të shohim se cila do të jetë përgjigjja nga ajo.

Ajo çfarë po synoj të them është që deri më tash nuk ka ndonjë dëshmi, fakt konkret që ne do të duhej vërtet të besojmë për një varrezë, e cila mund të ekzistojë në kuadër të varrezave të lagjes Buteli në Shkup.

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zonja Gashi?

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju i përmendët dy çështje, pra dy dyshime që këto janë viktimat të qytetarëve, të cilët kanë vdekur gjatë eksodit në Maqedoni dhe tjetra viktimat të vrara gjatë luftës, pra dy dilema.

Unë po ju them që viktimat, në fakt ata persona të cilët kanë ndërruar jetë është një temë tjetër dhe ka kërkesë prej qytetarëve që ata trupa të cilët janë varrosur në Maqedoni, personat që kanë ndërruar jetë atje të transferohen e të riatdhesohen në Kosovë, pra kjo është një çështje tjetër.

Ndërsa, sa i përket pyetjes, në fakt i kthehem thelbit, ka dëshmi, po ju them se ka incizime, ka video që ata trupa janë bartur nëpërmjet lumit Lepenc dhe janë dërguar në Maqedoni, mirëpo ju asnjëherë nuk kemi kërkuar prova të tilla.

KRYESUESI: Zoti Hoxhaj, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë të falënderoj nëse ju vërtet jeni në gjendje të na ofroni dëshmi.

Ne e kemi një 'fajll' të plotë, i cili flet për të gjitha angazhimet që janë bërë në vitet 2009, 2010, 2011, por nëse ju keni dëshmi konkrete materiale, sidomos video dhe fakte konkrete, unë jam në gjendje që në janar ta ngre një çështje të tillë. Kisha pasur dëshirë që ju të jeni pjesë e këtij delegacioni dhe të shohim se ku ka mbetur.

Në bazë të komunikimeve tona zyrtare, në nivel të zëvendëskryeministrave, në nivel të ministrave të Drejtësisë, në nivel të ministrave të Punëve të Jashtme, dhe në nivel të ambasadës sonë në Shkup dhe ambasadës së Maqedonisë në Prishtinë, ne nuk kemi pasur fakte të bollshme, të domosdoshme që vërtet të insistojmë për nënshkrimin e një marrëveshje të tillë. Nëse ju keni fakte, unë mund të them që nga 2 janari ne së bashku mund ta riinicojmë këtë proces.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Burim Ramadani, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Zoti Ramadani, e keni fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Trafikimi me qenie njerëzore dhe migrimi ilegal i qytetarëve të Kosovës sipas raporteve publike vazhdon të jetë shqetësues për Kosovën.

Pyetja ime konkrete është: Cilat janë të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme për këto dy dukuri negative gjatë vitit 2013 dhe çka saktësisht keni ndërmarrë për t'i luftuar këto dy dukuri negative që hyjnë në kuadër të krimit të organizuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ramadani,

Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar me luftimin e grupeve kriminale të përfshira në trafikim me qenie njerëzore dhe ato që lehtësojmë kontrabandimin me emigrantë, me qëllim të rritjes së efikasiteteve të institucioneve në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Si Ministri kemi sponsorizuar hartimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Ky ligj edhe më tej e ka forcuar bazën ligjore për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të trafikimit me njerëz. Gjatë vitit 2013, Policia e Kosovës ka trajtuar 146 raste të trafikimit me qenie njerëzore, ka realizuar 63 operacione dhe ka arrestuar 174 persona të dyshuar në përfshirje në trafikim me qenie njerëzore. Gjithashtu janë kontrolluar gjithsej 272 lokale, prej të cilave janë identifikuar 52 viktima të trafikimit dhe 40 prej tyre janë asistuar për riatdhesimin dhe rehabilitim.

Migrimi ilegal është një fenomen që karakterizon tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe një fenomen shqetësues, jo vetëm për ne, por edhe për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Shumë nga emigrantët kërkojnë jetë më të mirë sociale dhe ekonomike dhe kërkojnë mënyra të parregullta për të arritur këtë qëllim. Kjo i favorizon grupet kriminale të karakterit të krimit të organizuar, të cilat përfitojnë në tragjedinë e tyre.

Si Ministri e Punëve të Brendshme, gjithnjë duke e respektuar lirinë e lëvizjes së qytetarëve kemi punuar në drejtim të zvogëlimit të faktorëve shtytës dhe tërheqës që i quajmë ‘push’ dhe ‘pur feters’.

Në këtë drejtim kemi ndërmarrë masa parandalimi dhe luftimi të grupeve kriminale që merren me kontrabandim të emigrantëve. Në aspektin parandalues që nga viti 2011 kemi organizuar fushata vetëdijesuese për qytetarët kosovarë në lidhje me rreziqet që kanosen nga migrimi i parregullt.

Këto fushata janë intensifikuar dhe do të vazhdojmë edhe gjatë vitit 2014.

Në kuadër të luftimit të grupeve kriminale që merren me lehtësimin e kontrabandimit me emigrantë, Policia e Kosovës ka hetuar 10 raste...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Keni pyetje shtesë, zoti Ramadani?

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Më shumë si konstatim se sa si pyetje shtesë, por besoj që është goxha e qartë se ka një shpërputhje të dukshme ndërmjet asaj se çfarë niveli është veprimtaria e këtij lloji ose e këtyre llojeve të krimit të organizuar dhe veprimeve ligjore që janë ndërmarrë deri tash dhe normalisht edhe personave që kanë marrë dënimin, pra në tërësi. Ajo çka kërkohet dhe besoj se do të duhet që ministri i Punëve të Brendshme dhe Qeveria ta bëjë është jo vetëm në aspektin e fushatave dhe të reformës legjislative, por fuqizimi i kapaciteteve njerëzore brenda institucioneve të zbatimit të ligjit, sepse besoj se kjo është një prej temave që çalon. Ka pasur edhe raste kur me veprimtari të tilla janë raportuar që janë marrë pjesë edhe të afërm të niveleve të larta udhëheqëse të Kosovës, prandaj në raste të tilla decidivisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e ke fjalën, në qoftë se ke të sqarosh diçka.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Realisht, unë e pata edhe një pjesë shtesë të them që edhe me shtetet ku janë shqetësuese, si me Francën, Hungarinë e tjera, kemi kërkuar që t'i përshpejtojmë procedurat e dhënies së azilit për arsye se është si faktor tërheqës, konkretisht me Francën ende Kosova figuron si vend i pasigurt që gjatë vizitës kanë premtuar që do ta rishqyrtojnë dhe për atë kemi një numër shumë të madh, të cilët mendojnë se ka vend për azil. Ngjashëm është edhe me Hungarinë, ndërsa sa u përket operacioneve në luftimin e këtyre fenomeneve çdo herë arrihen rezultate më të mira, por për dënimet e fundit që i marrin këto, janë jashtë mundësive tona si Ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zonja Lama, kryeministri s'është këtu, mund ta bëni pyetjen. Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!
Pavarësisht se s'është kryeministri, unë do ta bëj pyetjen. Në Kosovë janë rreth 31 000 familje me 148 000 anëtarë që përfitojnë ndihmë sociale prej 40 deri në 80 në muaj. Këto shuma janë krejtësisht të pamjaftueshme për përmbushjen e nevojave më elementare edhe për një person, e lëre më për një familje disa-anëtarëshe.

Gjatë këtyre viteve, Qeveria ka bërë rritje të pagave për disa kategori, si për mësuesit, mjekët, policët e tjerë, por asnjëherë nuk është kujtuar për shtresën më të varfër të popullatës, e që janë pikërisht familje që marrin ndihmë sociale.

Në të vërtetë, çdo rritje page është shoqëruar edhe me rritje artificiale çmimesh, gjë që do të thotë se familjet e varfra e kanë pësuar dyfish.

Një gjë e tillë është përmendur edhe në raportin e sivjetmë të Bankës Botërore, e cila nxjerr Kosovën vendin më të varfër në Evropë.

Prandaj, pyetja ime për kryeministrin e Kosovës është kjo: Pse gjatë gjithë këtyre viteve nuk keni bërë asnjëherë rritje të shumës që jepet si ndihmë sociale, pse Qeveria e Kosovës anashkalon 148 000 banorët e saj që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme?

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri nuk është këtu. Besoj që sipas Rregullores, pyetja do të procedohet. Deputetja Donika Kadaj- Bujupi nuk është këtu, e ka një pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

Zonja Musliu, e keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Javën që e lamë pas në mediet tona u raportua dhe u tha e u fol shumë gjatë që për teke personale të mjekëve, patienti Shefki Sylja ka mbetur pesë orë në sallën e operacionit të

Repartit të Kirurgjisë Vaskulare, derisa ka intervenuar Policia, e ftuar nga familjarët e këtij pacienti.

I nderuar ministër,
Ju si Ministri e Shëndetësisë, a jeni në dijeni për rastin në fjalë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
E nderuar zonja deputete,
Ministria e Shëndetësisë është në dijeni për rastin në fjalë, por jo me të dhënat, të cilat i parashtruat në pyetjen tuaj.

Faktet flasin se pacienti në fjalë nuk ka mbetur pesë orë në sallën e operacionit, por më pak se 30 minuta dhe është kthyer në dhomën e tij deri në orën 11:30, kur intervenimi elektiv kirurgjikal është kryer brenda 30 minutave pasues.

Zhvillimet rreth këtij rasti, ku kanë qenë të përfshira edhe Policia edhe hetuesia e vendit e kanë dëmtuar rëndë imazhin dhe integritetin e institucionit më të lartë të kujdesit shëndetësor, nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor në vend, për çka Ministria do të kërkojë sqarim detaj nga institucionet e përfshira.

Njëkohësisht, ju informoj se të gjithë aktorët e ngjarjes janë dërguar në Komisionin Etik dhe Profesional të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe varësisht nga vendimi i këtij komisioni do të ndërmerren masat e tjera të përcaktuara me ligj, pra masat disiplinore.

KRYESUESI: Keni pyetje shtesë, zonja Musliu?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër!
Unë gjithmonë iu referova raportit të medieve, të cilat kanë raportuar që pacienti ka mbetur pesë orë në sallë. Ju thoni tash se nuk kanë qenë pesë orë, por 30 minuta. Pyetja shtesë: A janë të mjaftueshëm 30 minuta që një pacient të humbë jetën në rast se nuk i jepet ndihma kur është rast emergjent, e para dhe, e dyta, mendoj që më tepër sesa imazhi i institucionit ka vlerë jeta e një qytetari të Republikës së Kosovës. Prandaj, unë si deputete e këtij Parlamenti kërkoj që të merren masat urgjente dhe ata persona, ata mjekë, të cilët kanë neglizhuar jetën e një qytetari të Kosovës, të përgjigjen para organeve kompetente dhe të merren masa ndëshkuese për ta.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuar zonja deputete!
Masat ndëshkuese ndaj mjekëve do të merren vetëm në bazë të vendimeve të komisioneve meritore profesionale dhe jo vendimeve ose mendimeve të medieve, ose të

deputetëve. Në asnjë moment pacienti në fjalë nuk ka qenë i rrezikuar për jetë. Është bërë fjalë për vendosjen e një fistule arteriovenoze, e cila është parakusht për zbatimin e dializës dhe të jeni të bindur që jeta e pacientit në asnjë moment s'ka qenë e rrezikuar. Rënia nga programet operative është dukuri e përditshme jo në këtë institucion, por në të gjitha institucionet në botë për shkaqe të ndryshme, të cilat tash nuk dua t'i elaboroj më në detaje.

Të jeni të bindur se Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Njësia e Shëndetësisë është e përkushtuar deri në fund për shpëtimin e jetës së pacientit dhe këtë e ka dëshmuar në vazhdimësi dhe vazhdon ta dëshmojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Para se të bëj pyetjen për zotin Kuçi, unë edhe një herë dua të lidhem me përgjigjet që i dha ministri për pyetjen paraprake, sepse tha nuk do të bëhet ndëshkimi pse thotë një deputet. Nëse është ashtu, atëherë pse është dashur një pacient të mbetet 30 minuta në sallën e operacionit? Cila ka qenë arsyeja?

Pyetja ime për ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi është...

KRYESUESI: Atëherë prit se e more fjalën pa leje. Po ia jap mundësi ministrit për t'u përgjigjur.

MISNISTRI FERID AGANI: E nderuar zonja deputete!

Unë mendoj se nuk ka nevojë të keqkuptohemi. Përkushtimi ynë për ta përcaktuar përgjegjësinë, e thashë edhe në fjalën time, pse pacienti ka pritur 30 minuta para kryerjes së intervenimit, do të përcaktohet nga Komisioni përkatës Etik dhe Profesional i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës që merret me këtë rast.

Në qoftë se pala do të ketë ankesë në këtë vendim, është Bordi për Çështje Etike dhe Profesionale në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa në qoftë se edhe në këtë bord ka ankesë, është Oda e Mjekëve, e cila tash e ka formuar Komisionin Etik dhe gjithsesi përgjegjësia do të qartësohet deri në fund.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e kemi radhën zonja Musliu, me pyetjen për zotin Kuçi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesues!

Kërkoj falje që e mora fjalën pa rend në atë pjesën e parë, mirëpo trajtimi i deputetëve nga ministrat nuk është korrekt dhe unë do të bëj pyetjen për ministrin Hajredin Kuçi, edhe pse nuk është këtu. Mendoj që unë e kam obligim ta lexoj dhe thjesht ndihem e përgjegjshme për këtë çështje.

Javën që e lamë pas ndodhi edhe një absurd i radhës, kur kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi, u thirr në pyetje nga EULEX-i mbi dyshimet e bazuara plotësisht në shpifje dhe thashetheme të dëshmitarëve që tashmë po dihet publikisht - të shantazhuar dhe të montuar.

Pyetja e drejtpërdrejtë që e kisha për ministrin e Drejtësisë, që më vjen keq që nuk është sot këtu, është: Si ministër i Drejtësisë, zoti Kuçi kur do ta thoni fjalën tuaj në këtë drejtim?

Mendoj se ministria duhet ta luajë rolin e saj ose thjesht le ta shuajë misionin të cilin është dhe të mos shpenzojë para të kota në emër të institucionit përderisa asnjëherë nuk është përgjigjur në këtë çështje.

Qytetarët e Kosovës dëshirojnë ta dëgjojnë fjalën e kësaj ministrie për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Në numrin 8 të gazetës mujore 'Priporter' në disa media të shkruara përflitet se në kohën sa Zenel Kelmendi ishte rektor i Universitetit të Prishtinës, zotit Kuçi dhe disa ligjëruesve të tjerë u janë ndarë apo, thënë më mirë, u janë falur sipërfaqe të paluajtshmërisë në pjesën e qytetit të Prishtinës, që quhet Lagja e Universitetit.

Për më tepër, theksohet se këto paluajtshmëri janë regjistruar në librat kadastralë të Komunës së Prishtinës në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, me një vendim të datës 9 korrik 2003.

Ekziston dyshimi i bazuar se këto paluajtshmëri janë regjistruar në mënyrë të kundërligjshme në librat publikë, andaj edhe pyetja për ministrin e Drejtësisë është: Cila është e vërteta në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme? Mungesa e ministrit mendoj që është e qëllimshme për shkak se ai do të duhej të ishte këtu dhe të na shpjegonte se cilat procedura i ka ndjekur për regjistrimin e këtyre ngastrave, a posedon leje ndërtimi për shtëpinë që e ka ndërtuar dhe a e ka shpërblyer Zenel Kelmendin, i cili tash është këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë me këtë post? Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Ministri Besim Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në emër të Qeverisë dhe pas konsultimeve me grupet parlamentare, ne e tërheqim amendamentin 8.

KRYETARI: Ismet Beqiri, kryetar i Grupit, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Kryetar, unë të isha lutur, ju thashë edhe më herët, e kam një lutje që atë njoftimin e Grupit Parlamentar për zëvendësimin në Komision ta kryeni më herët për arsye, që ju tregova se në fund shpeshherë ose s'po ka kuorum, siç po ndodh në dy seanca, e sa i përket kësaj s'kam çka të deklarojem, sepse e kemi thënë qartë qëndrimin tonë sa i përket amendamentit. Kjo është shumë e qartë.

Unë ju lus që njoftimin ta bëni për Komisionin për Integritet.

KRYETARI: Faleminderit! Pra, a jeni dakord që ta bëjmë më herët këtë njoftim? Atëherë, ta bëjmë një votim formal. Faleminderit!

Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për ndërrimin e anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka propozuar deputeten Vjosa Osmani për kryetare të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, në vend të ish-deputetit Lutfi Haziri. Ndërsa deputetja Alma Lama propozohet anëtare e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që nëpërmjet një votimi formal dhe me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pra, votojmë edhe një herë. Faleminderit!

Kundër besoj që nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për ndërrimin e anëtarëve në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenin 42, pika 2, propozoj që në seancën e sotme të radhiten si pika të rendit të ditës pikat e mbetura më datën 12 shtator dhe 3 tetor të këtij viti.

Pra, votimi i raportit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e 75% dhe formimi i Komisionit Hetimor, i propozuar nga dy grupet parlamentare, ai i Lidhjes Demokratike dhe i “Vetëvendosjes”. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, i kemi dy mocione: kërkesën e ministrit që ka të drejtë ta tërheqë amendamentin 8, edhe pse ai është dashur për t’u futur si diskutim të votohet për të me 2/3 e Kuvendit, por megjithatë është tërhequr. Me një votim formal duhet ta bëjmë këtë dhe ta arsyetojmë kërkesën, ta miratojmë kërkesën e ministrit dhe mocionin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Por, për këtë mendoj se duhet të shkojmë me të parin, e për dytin duhet ta kërkojmë pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Pra, kush është që të votojmë për tërheqjen e propozimit të amendamentit?

(Ndërhyrje)

Nuk ka nevojë! Jo, një votim formal po e bëjmë. Kush është për? Faleminderit!

Pra, me shumicën absolute, Kuvendi e aprovon propozimin e ministrit për Financa.

Ndërsa për mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike duhet një mendim i grupeve. Fjalën ia jap kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Meqë hyri në rend të ditës, Grupi Parlamentar i LDK-së është kundër mënyrës së tillë të futjes në rend dite të këtyre dy pikave dhe ne do të votojmë kundër. Po ashtu, ne do ta lëshojmë seancën nëse këto dy pika vijnë në shqyrtim.

KRYETARI: Nga “Vetëvendosja”, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është për t’u përshëndetur kjo zmbropsje e Qeverisë në raport me futjen e paligjshme dhe jashtë rregullave të amendamentit 8, me rekomandimet për amendamentimin e Ligjit për buxhetin. Pra, kjo tregon në fakt që po të kishin dashur deputetët e subjekteve opozitare, të grupeve opozitare parlamentare, shumë gjëra të këqija që i ka bërë kjo Qeveri do të ishin ndalur, po të kishte qenë vullneti dhe gatishmëria e qëndrueshmëria, pra prej marrëveshjes e te Ligji për amnistinë e tutje, këto gjëra ishin ndalur, siç po ndalet tash edhe kjo futja e privatizimit të PTK-së përbrenda Ligjit për buxhetin.

Sa i përket mocionit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, mendoj se është i gabuar dhe për të mos thënë është e papranueshme mënyra se si paradite në seancë diskutojmë me gojën plot për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe pastaj pas gjysmë ore kërkohet që të futet një raport, i cili qartë është shkelje e ligjit dhe të votohet në seancë.

Pra, çka do të thotë kjo, Kuvendi paradite e mbron ligjin, e pasdite e shkel atë me të dyja këmbët.

Dhe, ne jemi absolutisht kundër që kjo pikë të futet në rend dite sot dhe natyrisht që nuk do të jemi pjesë e këtij Kuvendi në momentin kur ky vendos apo pranon ta shkelë ligjin siç e ka bërë Qeveria apo do të votojë ndryshe? Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe në seancat e kaluara kur është diskutuar për këto dy pika, ne e kemi mbështetur edhe Komisionin, edhe çështjen e votimit për ose kundër. Sidoqoftë, mendojmë se meqenëse një herë bën, një herë jo dhe prapë nuk ka konsensus, as ne nuk e mbështetim futjen e këtyre dy pikave në rendin e ditës sot. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se projekti i transaksionit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe investitorit për shitjen e 75% të aksioneve, në rast se kishim dashur të zbatohet ligji, është dashur të ndalet, pra s'është dashur të vijë deri te marrëveshja për transaksion. Ndërsa tash është në fund të transaksionit të këtyre dy palëve dhe esenca se si kemi ardhur deri në këtë gjendje si Kuvend, jemi në dijeni të gjithë, mirëpo në fakt dihet që është bërë anashkalim i Ligjit të ndërmarrjeve publike.

Ne nuk jemi që të mos hyjnë investimet e reja në Kosovë dhe i vetmi shans është që të përfundojë ky transaksion ndërmjet investitorit dhe Qeverisë, mirëpo me një sugjerim, ministrat tanë çdoherë ta kryejnë punën në fillim dhe të mos vijë deri te bllokimi i seancave plenare.

Ne do ta përkrahim edhe çështjen e rekomandimit të Komisionit Ndërministror, edhe të LDK-së dhe "Vetëvendosjes", për një Komision Hetimor. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit SLS, fjalën e ka kryetari Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržava predlog PDK-a da se ove dve tačke uvrste na današnjem dnevnom redu.

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, fjalën e ka kryetari Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržava ovu mociju i dopunu dnevnog reda sa novim tačkama dnevnog reda. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, Albert Kinoli e ka fjalën.

ALBERT KINOLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Duke pasur parasysh faktin se gjerë e gjatë dhe një kohë të gjatë po diskutohet për këto dy pika, të cilat kanë qenë shumë të diskutueshme, dhe meqenëse u dha veç rasti që këto dy pika të jenë në rend të ditës, Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin që këto dy pika të rendit të ditës të futen sot për diskutim. Faleminderit!

KRYETARI: Ne nuk po shkojmë në diskutim, nëse jeni dakord. Grupet parlamentare e kanë thënë fjalën e tyre, edhe pse i kemi dy kandidate - dy deputete të lajmëruara për diskutim.

Pra, shkojmë në votim.

(Ndërhyrje)

Atëherë, po e bëjmë një përjashtim vetëm për dy deputetet ta marrin fjalën. Mirë, sipas Rregullores, realisht na duhet prononcimi - qëndrimi i grupeve dhe atë e kemi kështu që s’po shkojmë hiç... Në sallë janë të pranishëm 111 deputetë, atëherë për këtë pikë kërkojmë votim elektronik.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kush nuk ka votuar me elektronikë, le ta ngrejë dorën! 1, 2, 3, 4. A i keni kartelat? Këtu i kam 113 kartela, pse nuk keni votuar me kartela?

Edhe një herë e provojmë, pra me kartela.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 59 vota për, 51 kundër, 1 abstenim, kalon mocioni për t’u futur pikat e fundit të rendit të ditës:

- 1. Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar të Kosovës lidhur me shitjen e 75% të aksioneve të Postë-Telekomit dhe*
- 2. Formimi i Komisionit Hetimor për shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së, i propozuar nga Lidhja Demokratike.*

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.*

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet e tyre.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe si përfundim i ka rekomanduar seancës që ta miratojë raportin me rekomandime.

Komisioni i ka zhvilluar aktivitetet e tij për shqyrtimin e Projektbuxhetit për vitin 2014 nëpërmjet grupeve punuese të ndara për shqyrtimin e Projektbuxhetit sipas sektorëve dhe organizatave të caktuara buxhetore sipas Rregullores së brendshme të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Të gjitha organizatat e pavarura dhe ato të nivelit qendror që kanë dërguar kërkesa buxhetore shtesë në komision janë ftuar në dëgjime buxhetore. Në dëgjimet buxhetore janë ftuar edhe institucionet tjera, të cilat komisioni i ka konsideruar se janë të nevojshme për të ardhur dhe për t'i arsyetuar nevojat e tyre buxhetore të paraqitura në buxhetin, të cilin e kemi pasur në shqyrtim, siç janë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale; Ministria e Infrastrukturës dhe Zyra Rregullatore e Energjisë dhe disa institucione të tjera.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar 52 kërkesa buxhetore, rekomandime dhe amendamente të deputetëve, komisioneve dhe grupeve parlamentare, ka mbajtur 28 dëgjime buxhetore, ku janë ftuar përfaqësuesit e organizatave buxhetore, përfshirë këtu edhe deputetët, të cilët kanë bërë amendamente në komision, që kanë paraqitur kërkesa buxhetore shtesë në Kuvend, ndërkaq në një takim të veçantë janë shqyrtuar të gjitha kërkesat buxhetore të komunave, ku kanë qenë gjithsej 14 kërkesa.

Në të gjitha takimet e grupeve punuese dhe të komisionit kanë qenë të pranishëm ministri i Financave dhe stafi i ministrisë, që kanë dhënë sqarimet e nevojshme për anëtarët e Komisionit. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në takimet e veçanta, i ka ftuar të gjithë deputetët që kanë dërguar amendamente, të cilët i kanë arsyetuar amendamentet e propozuara. Amendamentin e propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni, pas arsyetimit që e ka dhënë ai, komisioni e ka përkrahur pjesërisht, ndërkaq nuk është përkrahur propozimi

që t'u lihet mundësia që lista e ish të burgosurve politikë të mbetet e hapur, pra të jetë vjetore.

Pas dëgjimit dhe arsyetimeve për amendamentin e propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, që ka të bëjë me ndarjen mjeteve buxhetore për blerjen shërbimeve për strehimore, komisioni e ka ftuar në dëgjim buxhetor Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por është kërkuar informatë shtesë për këtë çështje, kështu që komisioni e ka përkrahur pjesërisht amendamentin e deputetes dhe në bazë të shënimeve që ka dërguar ministria përkatëse, ka rekomanduar rritjen e buxhetit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe programi i shërbimeve sociale, kategoria ekonomike, subvencione dhe transfere në shumë prej 168 000 euro, në emër të blerjes së shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Komisioni e ka shqyrtuar amendamentin e propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe ka rekomanduar rritjen e buxhetit të Zyrës së Kryeministrit për Komunitete, kategoria e subvencioneve, transfereve në kuadër të Zyrës të Kryeministrit, prej 200 000 eurove në emër të mbështetjes së medie minoritare multietnike dhe grupeve të tjera të veçanta, që është i përfshirë në amendamentin 11. Po ashtu, komisioni e ka përkrahur amendamentin e propozuar nga Suzan Novobërdaliu për ndarjen e mjeteve për ndërtimin e ujësjellësit të Kalaja, Qendra Turistike në Novobërdë, që është pjesë e komunës së Novobërdës.

Komisioni e ka përkrahur amendamentin e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovën e Re, që ka qenë njëherësh edhe kërkesë e Grupit Parlamentar “Ardhmëria e Bashkuar”, ndërkaq Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka përkrahur amendamentin e deputetes Albana Fetoshi që ka të bëjë me nenin 9 dhe rekomandon që të fshihet paragrafi 3.

Në amendamentet e propozuara, ndër të tjera, komisioni ka rekomanduar ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Ligjit për auditimin e jashtëm, ndarjen e mjeteve për mbështetjen e Universitetit të Pejës, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve për realizimin e projektit të nisur Fjalori i Enciklopedisë së Kosovës. Po ashtu, komisioni ka mbështetur edhe rekomanduar ndarjen e mjeteve buxhetore për Institutin Gjyqësor të Kosovës për projektin për trajnime të gjyqtarëve, si dhe ka rekomanduar ndarjen mjeteve për rritjen e numrit të të punësuarve në disa institucione të pavarura, siç janë Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni ka përkrahur disa kërkesa për financimin projekteve infrastrukturore të ndërtimit të rrugëve, të ujësjellësve, të kanalizimeve, nga të cilat përfitojnë qytetarët e komunave të ndryshme. I ka përkrahur të gjitha kërkesat e arsyeshme për transferin e brendshëm, të cilat janë bërë nga institucionet qeveritare.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe t'i miratojë të gjitha amendamentet, të cilat i ka miratuar Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat kryetaren e Komisionit. Kur të shkojmë te amendamentet që ka më shumë se një amendament dhe ka dallime në këtë, ne e zhvillojmë debatin që i takon amendamentit. A jeni dakord?

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

I kemi dy propozime, nga Komisioni Funkcional dhe nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kërkojmë që kryetari i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ta arsyetojë amendamentin.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Në fjalën që e pata për amendamentet, të cilat i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa, unë e ngrita edhe këtë çështje. Amendamenti i cili është i paraparë nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, për arsye se pjesa tekstuale që është përfshirë këtu nuk ka pasur mundësi të futet dhe të bëhet pjesë e buxhetit, për arsye se do të binte në kundërshtim me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës, mirëpo kërkesa e cila është bërë që të ndahen mjetet është realizuar, është pranuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe mjetet janë të ndara në një amendament tjetër, dhe janë të ndara 200 000 euro në Zyrën e Kryeministrit, në kategorinë subvencione dhe transfere, të cilat i dedikohen pikërisht ngritjes, mbështetjes, krijimit të fondit për mbështetjen e medieve minoritare multietnike dhe grupeve tjera të veçanta. Prandaj, kjo është ndarë, mirëpo pjesa tekstuale nuk ka pasur mundësi të përfshihet në buxhet.

KRYETARI: Propozuesi i amendamentit nuk e ka kërkuar fjalën dhe shkojmë sipas renditjes. E votojmë amendamentin 4, i propozuar nga Komisioni Funkcional. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, 26 kundër, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

I ka gjithashtu dy propozime. Propozimi i parë është i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i dytë është i deputetes Albana Fetoshi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Deputete, e ke fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Propozimi im ka të bëjë me heqjen e nenit, konkretisht të paragrafit 3 që parasheh krijimin e Fondit për veriun. Mendojmë si Grup Parlamentar që ky fond është diskriminues për qytetarët e vendit, sepse është i bazuar mbi ndarjet e thella etnike, të cilat do të kenë pasoja të rënda për të ardhmen politike të vendit.

Ky fond krijon pavarësi financiare për komunën veriore dhe kjo qasje vetëm sa e përforcon pozicionin e Serbisë për të mos i pranuar institucionet e Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur atje. Pra, ne po e shohim qëndrimin e atyre përfaqësuesve të cilët janë zgjedhur atje, qëndrimin që ata po e mbajnë. Mendoj që me krijimin e këtij fondi, ne vetëm sa e përforcojmë pozicionin e atyre përfaqësuesve atje që të mos i pranojnë edhe më tutje institucionet e vendit. Pra, deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë rastin tani që të votojnë për heqjen e këtij paragrafi.

Në diskutimin te deklaratimet jashtë rendit të ditës e vërejtja që edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kishte një qëndrim të vetin rreth kësaj problematike shumë të madhe. Mendoj që edhe pse është bërë një dëm shumë i madh me ratifikimin e marrëveshjes, tani deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë edhe një herë rastin që ta tregojnë veten, pra të votojnë për heqjen e këtij neni dhe të mos e përforcojmë edhe më tutje pozicionin e Serbisë brenda Kosovës, sepse po e them edhe një herë - krijimi i këtij fondi krijon pavarësi financiare dhe kjo pavarësi financiare mandej krijon pavarësi shumë të madhe politike që këta përfaqësues të zgjedhur, sidomos në komunën veriore, por edhe në komunat e tjera, parashihet krijimi i asociacionit në bazë të marrëveshjes që është miratuar në Kuvend. Pra, ne mund ta ndalojmë këtë, të paktën të mos kenë pavarësi financiare nëse votojmë kundër krijimit të Fondit për veriun.

Edhe një herë mendoj që përgjegjësia duhet të jetë maksimale e deputetëve karshi qytetarëve të vendit në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, i kemi dy propozime për amendamentin 5. Sipas renditjes, e votojmë amendamentin 5 të Komisionit FunkSIONAL. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 55 vota për, 23 kundër, 10 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Vazhdojmë. Edhe propozimin tënd do ta hedhim në votim. Mirë, e hedhim propozimin në votim. Lexojeni Rregulloren! Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë për amendamentin 5, të propozuar nga deputetja Alma Fetoshi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 32 vota për, 53 kundër, 7 abstenime, nuk miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

I kemi dy propozime, propozimin e Komisionit FunkSIONAL dhe propozimin e deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Mendoj që duhet ta ketë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

E ruaj të drejtën për të folur për amendamentin e dytë, sepse i pari është me përkrahje të Komisionit dhe le të trajtohet veç.

KRYETARI: Sipas renditjes, shkon votimi për amendamentin e Komisionit FunkSIONAL, e pastaj edhe amendamenti i deputetit Hydajet Hyseni. Fillimisht, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë amendamentin e Komisionit FunkSIONAL.

Me 50 vota për, 25 kundër, 4 abstenime, miratohet amendamenti i Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë për amendamentin e propozuar nga Hydajet Hyseni. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatitjen për votim. Votojmë tash!

Për amendamentin e propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni kanë votuar 43 deputetë, 28 kundër dhe 7 abstenime. I pari shkon se ka marrë 50 vota për, i dyti 43 vota për. Hydajet, e ke fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse pati një konfuzion, në të vërtetë mendoj që gjithçka është mirë kur përfundon mirë dhe mendoj se kjo siç përfundoi është e drejtë dhe logjike.

Amendamenti im ka përfshirë dy lloj ndryshimesh, një palë që janë përkrahur që në fillim dhe një palë pastaj që kanë premtuar më vonë që do ta përkrahim më vonë dhe janë ndarë në dy propozime këtu, në A dhe B. Prandaj, u bë mirë që u votua edhe A dhe B, sepse ashtu është edhe e drejtë. Për sqarimin e atyre që mund të mos jenë të informuar, nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Pjesa e parë, paragrafi A ka disa korrigjime që ju i miratuat me të drejtë. Për shembull, fjala: “financohen veteranët”, të zëvendësohet me “kompensohen”, sepse kështu është me ligj, kështu është edhe logjike dhe çështja e shprehjes të “përndjekurve” dhe që është tepër e gjerë dhe s’është në pajtim me ligjin, që është hequr. Ju këtë e votuat dhe bëtë mirë.

Në propozimin B, për të cilin e kërkoja fjalën, ju lutem, kjo ka të bëjë me diçka tjetër dhe mirë që u hodh në votim edhe pa shpjegimin tim, sepse e keni lexuar arsyetimin që e keni

të bashkëngjitur. Dhe kjo ka kërkuar vetëm një saktësim të mënyrës të realizimit të kësaj të drejte të miratuar me ligj në mënyrë koncesuale dhe këtu u dëshmuua se ky Kuvend e ka vullnetin edhe për të vazhduar tutje dhe hiqet vetëm keqkuptimi që mund të krijohet me mungesën e asaj që ligji e ka, Rregullorja e ka, praktikat e vendeve të tjera e kanë, që planifikimi i përgjithshëm duhet t'i nënkuptojë edhe vlerësimin, listat vjetore vit për vit, për të evituar mundësinë që krejt kjo të kuptohet si një bllokim për 5 vjet dhe tek më vonë të fillojë.

Megjithatë, Kuvendi ka miratuar drejt, ju siguroj dhe uroj që të realizohet. I falënderoj ata që janë angazhuar për realizimin e tij.

KRYETARI: Unë dua ta jap një sqarim, Hydajet. Është miratuar vetëm amendamenti i Komisionit Funksional, amendamenti juaj nuk është miratuar. Jo, neni 58, pika 4 thotë: Kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin vend të projektligjit që e përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili e merr numrin më të madh të votave, konsiderohet i miratuar. Në këtë rast, është miratuar varianti i Komisionit Funksional.

(Debate në sallë)

Ne mund të flasim sa të doni, por kur janë dy amendamente për të njëjtën çështje, ai që merr më shumë vota miratohet, ai që merr më pak vota nuk miratohet dhe nuk kemi çka të diskutojmë për këtë çështje më.

Amendamenti 8 është hequr dhe mirë që është hequr. Vazhdojmë.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Po, janë tri vota kundër. Miratohet amendamenti.

Amendamenti 18

Kundër, sa janë? 13. Ku janë ata 13?

Pra, e hedhim në votim elektronik, nuk ka asnjë problem.

Amendamenti 13 shkoi me votim elektronik. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 58 vota për, 21 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, 6 kundër, 7 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? 3. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë me elektronikë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash për amendamentin 44, i propozuar nga Koalicioni Kosova e Re, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Me 55 vota për, 20 kundër, 7 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47 i deputetes Donika Kadaj-Bujupi, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 31 vota për, 23 kundër, 5 abstenime, nuk miratohet amendamenti 47, i propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Në sallë e kemi praninë fizike 110 deputetë, prania elektronike 113. E votojmë me elektronikë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 57 vota për, 48 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014. Bëjmë pauzë. Në orën 15:00 e vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Menjëherë duhet të fillojmë me procedurën e votimit, pasi nuk kemi deputetë për të filluar votimin e amendamenteve. Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kërkoj mirëkuptimin dhe vëmendjen tuaj për një çështje, për të cilën kemi ardhur deri këtu bashkërisht me konsensus dhe besoj shumë se mund të vazhdojmë me konsensus. U mor vesh nëse i heqim keqkuptimet dhe eventualisht lojërat ndonjëherë që duken procedurale, por që janë politike dhe mund ta ngatërrojnë një proces të ndjeshëm.

E kam një mocion procedural për trajtimin e votimit që u bë në nenin 7 të Ligjit për buxhetin, në të cilin u trajtuan dy amendamente si pjesë e një amendamenti. Për sqarimin tuaj, ato ndryshime kanë qenë të propozuara prej meje, nuk janë propozuar nga komisioni. Nuk më ka prishur punë pse komisioni i ka trajtuar ndryshimet e para si të vetat, sepse në parim ishin korrigjime. Por, ato nuk kishin të bëjnë fare me ndryshimin që ishte lënë si propozim imi, e që u votua në vete.

Të dyja këto amendamente u miratuan nga Kuvendi. Interpretimi se meqë janë të të njëjtit amendament, amendamenti që ka marrë më shumë vota e përjashton të dytin, është i lëndueshëm proceduralisht.

Në Rregulloren e Kuvendit, kjo dispozitë vjen në shprehje vetëm në rastet kur bëhet fjalë për të njëjtën çështje, kur një ndryshim e kundërshton ndryshimin tjetër, e kjo nuk ka ndodhur në rastin tonë.

Ndryshimi i parë që u votua me vota më shumë prej të gjithëve ka të bëjë me çështje terminologjike. Në vend të “financimit”, “kompensimi” sipas ligjit dhe heqja e asaj që është në kundërshtim me ligjin - përfshirja e të përndjekurve. Por, kjo s’ka të bëjë aspak me trajtimin kohor, do të thotë paraplanifikimin kohor dhe nevojën që të insistohet në planifikimin vjetor. Ose mund të bëhet në atë mënyrë, ose interpretimi mund të lërë të kuptohet sikur është fjala për një dispozitë që mund të jetë bllokuese.

Unë jam i bindur që deputetët nuk e kanë këtë qëllim. Besoj shumë se edhe Qeveria, edhe ministri që e ka propozuar, nuk e ka këtë qëllim. Kështu na është thënë.

Prandaj, mendoj që të dyja amendamentet janë votuar, të dyja janë miratuar dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. S’kanë asnjë lidhje njëra me tjetrën. Përndryshe, po u konsiderua kjo praktikë, po të jem unë kryetar komisioni, me një ndryshim terminologjik, në të cilin nuk fitoj qind për qind të votave, do ta bëj të pamundur çdo ndryshim të forcave tjera politike. Nuk ndodh askund në botë.

Prandaj, mendoj që do të ishte mirë që të korrigjohet në këtë mënyrë, si seancë, qoftë edhe në format që praktikohen ta zëmë me votim dhe që të mos lejohet që kjo çështje të bëhet objekt i procedurave nga të cilat unë nuk e kam ndërmend të heq dorë.

Parimisht kam të drejtë dhe nuk e shoh të arsyeshme që të abuzohet me atë, sepse kjo mund më ngjall dyshime pastaj që janë jorastësisht, jo keqkuptime. Kërkoj mirëkuptimin tuaj, kërkoj mirëkuptimin tuaj kryetar, vetëm në rastet kur e përjashtojnë njëra-tjetrën bëhen ndryshimet në fjalë.

Në këtë rast nuk kanë qenë në kundërshtim njëra me tjetrën. Vetëm krahasojeni, e para është terminologjike, gjuhësore, e dyta është përmbajtjesore. Ne s'e kemi votuar të parën në raport kundërshtimi e me të dytën, as të dytën me të parën. Amendamenti i dytë është i deputetit, nëse është miratuar është në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet,

Unë personalisht kam qenë për t'u votuar vetëm pjesa e amendamentit që ka qenë në emrin tënd. Ta kam dhënë fjalën, nuk e ke sqaruar. Ju me komisionin, se si keni biseduar, nuk është çështje imja, është çështje tjetër.

Komisioni nuk ka dashur që amendamentin tuaj ta marrë për vete dhe ta ndajë pjesën që i konvenon komisioneve dhe Qeverisë në pjesën që s'i konvenon komisionit dhe Qeverisë. Kjo është çështje e komisionit.

Ne si Kuvend i kemi votuar dy variante të një amendamenti. Është neni 12, pika 4, dhe ai mund të ketë më shumë se një amendament dhe këtë është dashur ta sqarosh me komisionin.

Rregullorja shkruan qartë: kur janë dy apo më shumë variante të amendamenteve, cili variant merr më shumë vota konsiderohet i miratuar dhe tjetri, edhe pse mund të ketë vota, nuk mund të jetë i miratuar. Është fjala për një amendament, bërë për një nen të ligjit dhe bile për një paragraf të ligjit. Kjo është gjendja që dihet.

Njëri amendament, ose amendamenti i komisionit, ose amendamenti juaj është dashur të bjerë. Në këtë rast ka rënë amendamenti juaj.

(Ndërhyrje)

Kush po thotë? Jo! Bile ju kam thënë ta votoni amendamentin e Hydës. Bile e kam tejkaluar edhe përgjegjësinë time që e kam, por ju nuk e keni kryer detyrën tuaj. Edhe nuk e ka sqaruar Hyda para se të votohet. Nuk e ka sqaruar amendamentin në tërësi, edhe pse ia kam dhënë fjalën.

Kështu që, nëse ka ndonjë formë që e bën këtë ndryshim le ta bëjë, por tani për tani kjo është gjendje që e kemi kapërcyer.

Vazhdojmë me pikën 4:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Në sallë i kemi 81 deputetë të pranishëm.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëhendetje për ministrat,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, më 19.11.2013 dhe më 17.12.2013 e ka shqyrtuar dhe miratuar në komisionet funksionale Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Komisioni ka pasur parasysh objektivat e këtij ligji dhe në rend të parë përshtatshmëria e ndërtimeve pa leje në planifikimin hapësinor të Kosovës që nënkupton rrënimin e ndërtimeve pa leje që janë në kundërshtim me planin hapësinor dhe legalizimin e ndërtimeve pa leje që nuk e pengojnë planin hapësinor të Kosovës.

Ky ligj nuk ka ndikim buxhetor.

Arsyetimi është se ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të identifikuara dhe në hartën ortopote digjitale, bazuar në incizimin ajror fotogjeometrik në Republikën e Kosovës.

Ky ligj e ofron një program uniform në trajtimin e ndërtimeve pa leje, që do të zbatohen në tërë Republikën e Kosovës.

Ky ligj duhet të hyn në fuqi për tre vjet.

Opinionet e komisioneve janë në pajtim që ky ligj të miratohet, Komisioni për Legjislacion, për Buxhet dhe Financa, ai për Komunitete dhe Kthim, si dhe për Integritet Evropiane.

Komisioni i ka pasur edhe debatet me grupet punuese dhe në takimet e mbajtura i ka miratuar raportet me amendamente, të cilat e funksionalizojnë ligjin si në tërësi, duke i mbështetur sugjerimet ndaj ekspertëve dhe zyrtarëve të ftuar nga HABITAT-i, Asociacioni i Komunave, organizata e OSBE-së e të tjera.

Prandaj, Komisioni kërkon nga Kuvendi ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që ky ligj është njëri prej ligjeve ndoshta më të mira dhe më të rëndësishme në Kosovë, të paktën për Komisionin të cilit unë i takoj. Është e vërtetë që mbi 73% e ndërtimeve në Kosovë është pa plan rregullativ dhe pa legalizim.

Por, ajo që më shtyri sot ta marr fjalën është se ky ligj i jep kompetenca drejtpërdrejta ministrit të Planifikimit Hapësinor në nenin 4, pika 2, dhe në të njëjtën kohë u jep të drejta ekskluzive kryetarëve të komunave, me theks të veçantë kryetarit të sapoemëruar sot Shpend Ahmetit. Ajo që unë sot kërkoj është që ministri, pas miratimit të këtij ligji, të na japë një përgjigje sa më shpejtë se çka do të ndodhë me objektin “Pandora”, meqenëse ai objekt është përmendur me emrin tim.

Dhe, unë dëshiroj, edhe për opinion publik, por edhe për ju këtu si kolegë deputetë, edhe për ju ministër, që t’i merrni masat sikur në rastin në Prevallës, urgjentisht para opinionit publik, por pse jo edhe për implementimin e ligjit, e keni të drejtën, për ta implementuar këtë ligj dhe të jepet një përgjigje për opinion publik se çka do të ndërmerrni rreth këtij rasti, meqenëse është përfolur shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi.

Të pranishëm 80 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 73 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi ligjin numër 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me rregullën 57, pika 1 dhe 9, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura e shqyrtoi Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e produkteve të vogla dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që t'i miratojë amendamentet, të cilat i ka propozuar Komisioni.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i tarifave të veçanta të akcizës për prodhuesit e vegjël të produkteve alkoolike dhe caktimin e metodës për përcaktimin e sasisë dhe përqindjeve të alkoolit të produkteve alkoolike. Me këtë projektligj synohet rregullimi i ambientit biznesor, nxitja dhe stimulimi i prodhimtarisë vendore, si dhe mundësia e prodhuesit vendor të konkurrojë me produktet e tyre në tregun e Kosovës.

Masat e propozuara për tarifat e veçanta për akcizën për prodhuesit e vegjël të produkteve alkoolike janë në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian për stimulimin e prodhimit vendor.

Komisioni ka vlerësuar se zbatimi i Projektligjit për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë është i përballueshëm për Buxhetin e Kosovës dhe ka ndikim pozitiv në të hyrat e brendshme buxhetore si rezultat i rritjes së prodhimit vendor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa njëzëri i ka miratuar amendamentet të cilat i janë ofruar sot seancës për miratim. I kisha lutur deputetët që t'i miratojnë amendamentet, të cilat janë miratuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ky projektligj dhe projektligji që vjen pas tij janë projektligje që kanë probleme, kanë pasur në të kaluarën dhe problemi ka qenë dyzimi sa u përket anekseve dhe ky dyzim nuk është zgjedhur shumë qartë, mirëpo nuk ka ardhur në Komision edhe Komisioni nuk ka mundur ta trajtojë. Ka ardhur direkt në seancë. Nuk e di pse nuk ka ardhur në Komision. Vetëm si njoftim për seancën, seanca le të vendosë si të dojë. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Vazhdojmë me votimin.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 77 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë.

Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zonjën Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat për tarifë zero të tatimit doganor është projektligj që një kohë të gjatë është në Kuvendin e Kosovës dhe ne si Komision për Buxhet dhe Financa jemi përpjekur që bashkërisht të gjithë anëtarët e Komisionit të gjejmë zgjidhje që ky ligj më në fund t'i kalojë procedurat dhe të jetë një ligj i zbatueshëm për arsye se është një ligj shumë i rëndësishëm për biznesin në Kosovë.

Komisioni për Buxhet ka punuar intensivisht dhe ka bërë disa plotësime-ndryshime në nenin 3 të këtij projektligji dhe e ka fshirë nga projektligji nenin 4, në të cilin ka pasur kontestime nga Presidentja. Një propozim të cilin tash ne e kemi dhënë është në pajtim me praktikat rajonale dhe evropiane që kanë për qëllim përkrahjen e bizneseve nëpërmjet politikës fiskale, respektivisht lirimin e produkteve të ndryshme të kafshëve, shtazëve, të bimëve që janë mallra me tatim 0 doganor, produkteve medicinale dhe lirim të mallrave, të cilat janë të liruar nga tatimi doganor, mallrat e eksportit, mallrat e importit nga misionet diplomatike ose konsullore dhe personeli i tyre, përveç personelit të punësuar.

Ne e dimë që Kosova ka nënshkruar disa marrëveshje për tregti të lirë dhe është në negociata me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit dhe me përfundimin e kësaj marrëveshjeje ky ligj edhe do ta humbë efektin, ngase do të kemi liberalizim të tregtisë të lirë dhe ruajtjen e tatimeve doganore, por deri në atë kohë është shumë e rëndësishme që të miratohet ky ligj, pasi do t'u ndihmonte bizneseve dhe do të lehtësonte veprimtarinë e tyre, duke përfituar nga lirimet doganore që faktikisht i garanton ky ligj, nëse miratohet.

Prandaj, i kisha lutur deputetët që sinjerisht të angazhohen që votën e tyre ta hedhin pro këtyre amendamenteve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që t'ua krijojmë mundësinë bizneseve që ta vazhdojnë punën dhe veprimtarinë e tyre, sepse është në favor të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Mendojmë se nuk kemi nevojë për diskutim e as për debat, por ju njoftoj që për miratimin e amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL duhen 61 vota. Nëse nuk i marrim 61 vota nuk miratohen, kështu që shkojmë me votim të amendamenteve.

Është përgjegjësi e kryetarëve të grupeve parlamentare që t'i kenë deputetët në sallën. Nuk është punë jona që t'i presim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Jo! Edhe një herë e përsëritim, nuk ka me dorë, por me elektronikë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë edhe një herë.

Konstatohet se me 65 vota për, 5 kundër, 2 abstenime, Kuvendi i miratoi amendamentet e Komisionit.

Vazhdojmë, i kemi edhe dy pika shtesë. Prania fizike e deputetëve në sallë, ajo elektronike është 60.

Prania elektronike, ju lutem! Kush është këtu, le të votojë! Regjia, prania elektronike na duhet! Cila është prania fizike? 53. Ristartojmë edhe një herë!

Prania elektronike është 52 deputetë në sallë. Tani 54 deputetë janë në sallë dhe nuk kemi kuorum për të vazhduar.

Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam munguar një kohë këtu në Parlamentin e Kosovës, dhe kam dashur që sot, ose kurdo që të më jepet rasti të flasim për gjëra, ose diskutimi të jetë për gjëra pozitive. Fatkeqësisht, kjo situatë sot, në të cilën është Parlamenti i Kosovës, e që është duke u bazuar për një kohë të gjatë e tregon më së miri situatën dhe problemet me të cilat po ballafaqohemi ne këtu. Mungesa e deputetëve të Parlamentit të Kosovës, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, situata në të cilën ka ardhur Parlamenti i Kosovës për të larguar njerëzit nga Parlamenti flet vetvetiu.

Unë nuk e di a do të ketë mundësi, përveç diskutimeve tona, të nxirret vendim apo jo për faktin që sipas Rregullores duhet ai kuorum për të pasur vlefshmëri të vendimeve.

Por, ajo që unë dua të tërheq vëmendjen, që t'i them disa fjalë dhe ta shfrytëzoj rastin është të flas për gjendjen e krijuar.

Së pari, mua më vjen keq që sot 90% e Qeverisë së Kosovës nuk është këtu. E dyta mendoj që është alarm, është një alarm për ata të cilët e kanë udhëhequr procesin e privatizimit të Postës. Pse të vijë Parlamenti në një gjendje të tillë sot, pse të vijë në një situatë ose për të vazhduar këto dy vjet e më tepër me situata të tilla që të mos mund ta marrë një vendim për të ecur përpara?

E kam përshtypjen që këto kohë rreth diskutimit për Postën është biseduar sipërfaqësisht e jo përmbajtësisht, dhe në vend që ne flasim për procedurat për të vazhduar drejt implementimit të projekteve, flasim kush është për e kush është kundër.

Unë nuk kam parë, përveç ndonjë rasti të veçantë, disponimin e shumicës të deputetëve të Parlamentit të Kosovës që nuk janë për privatizimin e kësaj ndërmarrjeje publike. Mirëpo, dikur në çdo privatizim dhe për çdo gjë tjetër duhet të respektohet Ligji për ndërmarrjet publike.

Pse Parlamenti i Kosovës sot është këtu ku është? Mendoj se përgjegjësit kryesorë duhet ta na e shpjegojnë neve këtu, t'ua shpjegojnë edhe palëve të interesuara.

Gjendja në të cilën është ndërmarrja më profitabile e Republikës së Kosovës, që është Posta, është një gjendje e rëndë.

Në qoftë se sot nuk merren vendime të merituar, kjo gjendje do të jetë edhe më e keqe.

Më kujtohet viti 2008, kur ne e kemi bërë vlerësimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, vlera e saj ka kaluar 1 miliard euro. Ndërsa sot është në shitje 200 e sa milionë. Nëse vazhdohet me këtë rrugë, kjo vlerë do të vijë duke u zvogëluar.

Për tre vjet, Postës së Kosovës i janë ndaluar investimet dhe po të fillohet sot me investime, ... nuk do ta gjejë konkurrentin e vet dhe vazhdimin e investimeve në projekte, të cilat u kanë mbetur pa i realizuar.

Të nderuar kolegë, edhe ata të cilët e kanë drejtuar këtë proces - komisioni ndërministror, pse e keni sjellë gjendjen sot në këtë situatë të Postës dhe të Parlamentit të Kosovës?

Ligji për ndërmarrje publike saktësisht e tregon se si shkohet drejt një privatizimi. Nuk ka ligj për privatizim të ndërmarrjeve publike, ka vendim. Një ligj për privatizimin e ndërmarrjeve publike është nxjerrë një herë. Vendimi për privatizimin apo jo të ndërmarrjeve publike merret në Parlamentin e Kosovës. Kjo është detyrë e Parlamentit të Kosovës dhe pastaj procedurat për fazat dhe mënyrat e privatizimit deri te implementimi është detyrë e Ekzekutivit.

Në qoftë se sot ftohet që të votohet diçka, të votohet pasi krejt këto procedura janë kryer, thjesht në njëfarë mënyre në Parlamentin e Kosovës formohet një komision vlerësues.

Në anën tjetër, unë kërkoj që nga kjo situatë të dilet duke e gjetur një gjuhë të bashkëpunimit me grupacionet tjera politike. Po ju ftoj, drejtuesit dhe liderët, ose shefat e grupeve parlamentare që të ulen dhe ta gjejnë një kompromis. Cili është kompromisi? Për arsye se kemi ardhur në një situatë jashtëzakonisht të rëndë që në çfarëdo varianti dëmtohet vendi ynë. Edhe nëse ka dështuar privatizimi i Postës, ata që kanë shkruar le ta kuptojnë se nuk ka fituar Kosova. Po edhe nëse vazhdohet me këtë mënyrë, nuk besoj që fiton vendi, përderisa nuk arrihet një kompromis i përbashkët për të gjetur një zgjidhje për të ecur përpara.

Vërejtjet e mia janë kryesisht te drejtuesit, drejtuesit - në këtë rast ministrinë përkatëse. Një ministër, i cili nuk është në gjendje të shkojë sipas ligjit dhe t'i marrë në përgjegjësi vendimet e veta është mirë ta masë përgjegjësinë morale - të japë dorëheqje. Pse e ke sjellë Parlamentin në këtë gjendje? Nuk ka pasur nevojë asnjëherë Posta të vijë këtu e të diskutohet. Vendimi për privatizimin e Postës është dashur të bëhet dhe është bërë herët. Pse të vijë në këtë situatë? Kur ju nuk jeni të gatshëm të merrni vendime, të merrni përgjegjësi për procesin, është mirë të dilni u t'u thoni edhe deputetëve, edhe qytetarëve, se 'unë nuk jam i gatshëm ta marr përgjegjësinë, jam i gatshëm t'i marr privilegjet'.

Ku keni dëgjuar ju, që pas krejt procedurave që i keni kaluar të privatizimit, vini në Parlamentin e Kosovës dhe thoni 'miratojeni atë që e kam bërë unë'.

Kjo është në kundërshtim me ligjin, të nderuar kolegë. Ne po flasim për çështje parimore. Sot ju kërkon nga ne ta shkelim ligjin për ndërmarrjet publike. Për çka? Për një gabim, për një mosrespektim të procedurave me kohë. Ose, thënë më mirë - për moskompetencë.

Në qoftë se vendimi për privatizimin e Postës ka kaluar në buxhetin e vitit 2012, a kur ka qenë, pse duhet të merret vendim përsëri? Nuk është ligj ky! Vendimi një herë merret për privatizim dhe ai është i vlefshëm gjithmonë. Mund të vijë një përbërje e re e Parlamentit për ta ndryshuar.

A keni juristë ju në zyrën tuaj? A e keni zyre juridike, e cila ju udhëzon e ju tregon se si duhet të shkohet deri te procesi i privatizimit. Po ju çka bëni? Ju e hidhni në përgjegjësi Parlamentin dhe çka komentohet këtu, në qoftë se dështon, e si po duket po dështon privatizimi i Postës, ju nesër keni për të thënë - 'Parlamenti i ka fajet pse nuk është privatizuar Posta'.

Edhe unë po ju them, zoti ministër, juve që e keni udhëhequr këtë proces, fajtori kryesor për gjendjen të cilën e keni sjellë sot, edhe në degradimin e Postës, edhe në mosinvestimin në Postë, edhe humbjen e vlerës së Postës, edhe për këtë gjendje ku jemi sot, jeni pikërisht ju si komitet ndërministror dhe nuk është faji i Parlamentit.

Ju jeni jokompetentë, ju nuk guxoni të merrni vendime, ju nuk e njihni ligjin. Njëra nga këto ekziston. Cila është, ju duhet të na e thoni neve.

Parlamenti i Kosovës duhet të vendosë - nuk privatizohet Posta, fajet i ka Parlamenti. Pse? Pse ende s'u bë komisioni vlerësues të ma vlerësojë mua atë që i kam kryer krejt procedurat. Jo, kjo është për t'u tallur me Parlamentin e Kosovës. Dhe, është normale që të mos pritet prej deputetëve të shkohet deri në atë shkallë të ofendimit dhe talljes me intelektin e tyre.

Unë mendoj se duhet gjërat t'i bisedojmë ashtu, se nuk është këtu luftë e grupeve politike. Unë nuk e shoh këtë luftë të grupeve politike. Unë flas për çështje parimore. Po ta kishim një komitet ndërministror kompetent duke e respektuar ligjin, s'do të vinte puna deri këtu.

Ma gjeni ju mua një rast, kur një ndërmarrjeje publike është privatizuar dhe ka ardhur deri te shitja, është përcaktuar fituesi dhe hajde tash në Parlament i miraton. Pse të vijmë në këtë situatë?

Në anën tjetër, përsëri po them, mirë është ta dinë qytetarët e Republikës së Kosovës, edhe ne si deputetë: në qoftë se Posta e Kosovës me këtë vlerë, sado të vogël, dhe me këtë proces siç ka shkuar nuk ecën përpara, vitin e ardhshëm do ta kemi shumë e përgjysmuar. Edhe më shumë do t'i bjerë vlera Postës së Kosovës.

Është mirë ta dinë qytetarët e Kosovës se për shkak të këtij komisioni ndërministror për 3 vjet këta ia kanë humbur vlerën Postës së Kosovës me qindra milionë euro, duke e zvarritur procesin e privatizimit. Duke e zvarritur procesin e privatizimit! Sepse këta njerëz nuk janë të gatshëm të marrin përgjegjësi... Sikur këta njerëz që nuk kanë qenë të gatshëm që 5 vjet ta bëjnë, një tullë ta hedhin për termoelektranën....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetëm, më shkurt! Edhe për një minutë a dy!

FATMIR LIMAJ: Nuk po e zgjas, edhe ashtu s'kam folur goxha moti.

Ajo që unë po e them, nuk do të duhej këtu t'i quajmë kush janë fajtorët, kush po e bllokon dhe kush s'po e bllokon. Kam dëgjuar nga ministrat që shkojnë nëpër televizione e thonë 'Parlamenti i ka fajet që s'po privatizohet Posta'. Jo, jo! Merreni përgjegjësinë, të nderuar kolegë. Merreni përgjegjësinë se e keni marrë detyrën me dëshirën e juaj dhe aty ku ju e keni përgjegjësinë dhe detyrën për ta kryer, mos ua hidhni deputetëve. Merreni përgjegjësinë që u takon.

Unë besoj se ne që jemi këtu dhe shumë tjerë që s'janë, nuk janë kundër privatizimit dhe ai kush është kundër privatizimit është edhe kundër këtij sistemi, të cilin e kemi miratuar ne vetë. Ama, së pari, të na tregohet pse erdhi gjendja deri këtu.

Kush është fajtor që tre vjet Posta e Kosovës mbahet pezull? Kush është fajtor që sot në Postën e Kosovës nuk ka menaxhim? Ajo është në një status quo, ajo thjesht mbahet sot për nesër. Çdo projekt investiv atje është shprehur me vendimin tuaj, ndërsa konkurrenti i saj është duke ecur shumë përpara dhe sot jemi këtu në sekondën e fundit dhe lirisht mund të thotë ministri që nëse s'privatizohet sot Posta, nesër ai blerësi thotë unë heq dorë prej kontratës, që është gjëja më normale. Hiqet, po! Dhe, cili është dëmi? Jo ta këqyrim fajtorin, por cili është dëmi? Pak është me rëndësi kush është fajtori, këqyreni dëmin.

Dëmi është për Kosovën, është edhe për ndërmarrjen, është edhe për punëtorët, është edhe për ne të gjithëve, si qytetarë të këtij vendi. Prandaj, është koha dhe momenti t'i merrni përgjegjësitë që ju takojnë dhe të mos e gjuani topin dhe ta nderoni dhe respektoni Parlamentin e Kosovës. Niseni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdo, edhe për pak...

FATMIR LIMAJ: Nëse e respektoni dhe e nderoni Parlamentin e Kosovës, sot e votohet për buxhetin, që është ligji më i rëndësishëm i Qeverisë, dhe këtu mungon pjesa dërmuese e Qeverisë së Kosovës. Është momenti i fundit të respektohet ky Parlament. Faleminderit kryetar!

Harrova edhe diçka, se kam dëshirë shumë i hapur të jem. Vota ime, unë s'kam marrë pjesë as në debate politike, as andej... Por, vota ime nuk shkon për faktin se me vetëdije nuk e shkeli ligjin, sepse është në kundërshtim me Ligjin për ndërmarrjet publike çfarëdo votimi sot për atë çështje të cilën e keni shtruar. Vendimi për privatizimin e postës është dashur të merret para se të zhvillohen këto procedura.

KRYETARI: Nuk kemi kuorum për debat, as për vendimmarrje. Përndryshe sot...

(Ndërhyrje)

Ju lutem, i drejtohesh prej Qeverisë se tërë ditën asnjë minutë sot s'e keni marrë fjalën. Hiç! Qeveria s'ka fjalë sot! Është dashur të jetë më e përgjegjshme me praninë e saj këtu.

E mbyllim këtë seancë. Vendimin për mbylljen e sesionit e marrim në Kryesi, të hënën. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*